



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS**

# **BULETINI ZYRTAR**

**NR.3, 2008**

**TIRANË, 2008**



Botuar nga: Autoriteti i Konkurrencës  
Përpunimi grafik: Erald Lamja  
Shtypur nga: Shtëpia Botuese Afrojdit

© Autoriteti i Konkurrencës, Tiranë, 2008

## Përmbajtja

- Fq.5 Vendimi nr.70 datë 11.01.2008 “Mbi Autorizimin e përqendrimit të Bankës Credins Sh.A me BFSE Holding BV & SIFEM AG”
- Fq.8 Vendimi nr.71 datë 29.01.2008 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs Gmbh (UNIQA).”
- Fq.13 Vendimi nr.72 datë 19.02.2008 “Për Rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative në fushën e energjisë”
- Fq.16 Vendimi nr.73 datë 29.02.2008 Për Miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007 dhe objektivat për 2008”
- Fq.17 Vendimi nr.74 datë 11.03.2008 “Për Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve”
- Fq.19 Vendimi nr.75 datë 21.03.2008 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 51% të kapitalit të shoqërisë Trema Engineering 2 Shpk të shoqëria Strabag SE”
- Fq.23 Vendimi nr.76 datë 07.04.2008 Për Miratimin e Udhëzimit “Për Përcaktimin e Tregut Përkatës”
- Fq.24 Udhëzim “Për Përcaktimin e Tregut Përkatës”
- Fq.36 Vendimi Nr.77 datë 11.04.2008 “Për Disa Rekomandime për Tregun e Telekomunikacioneve”
- Fq.41 Vendimi Nr.78 datë 25.04.2008 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 65% të kapitalit në shoqërinë Alba Cement Italia shpk nga shoqëria Antea Cement Sh A”
- Fq.46 Vendimi Nr.79 datë 2.05.2008 “Për Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të përbashkët mbi pjesën prej 67 % të kapitalit aksionar në Media Vizion Sh.A nga shoqëritë Spot AG & Ost’holding GmbH”
- Fq.49 Vendimi Nr.80 datë 05.06.2008 Mbi Miratimin e rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”
- Fq.51 Rregullore “Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”
- Fq.61 Vendimi Nr.81 datë 10.06.2008 Për “Përrjashtimin nga Ndalimi i Marrëveshjes së lidhur midis American Express Limited (AMEX) dhe ALPHA BANK A.E”

- Fq.66 Vendimi Nr.82 datë 23.06.2008 Mbi Miratimin e Udhëzimit “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit” si dhe anekset përkatës I dhe II të bashkëlidhur.
- Fq.68 Vendimi nr.83 datë 02.07.2008 Për Miratimin e “Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin e Konkurrencës”
- Fq.69 Rregullore e Brendshme Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike në Autoritetin e Konkurrencës
- Fq.78 Vendimi nr.84 datë 14.7.2008 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të përfuturit të plotë të kontrollit në shoqërinë EUROMAX Shpk nga shoqëria DELTA MAXI d.o.o dhe shoqëria Weakstead Real Estate B.V”
- Fq.81 Vendimi nr.85 datë 29.07.2008 Mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Wrigley Jr. Company dhe shoqërisë Mars Incorporated”
- Fq.86 Vendimi nr.86 datë 29.07.2008 “Për mos klasifikimin si përqendrim të bashkimit me përthithje të shoqërive CT Telekom dhe Albtelekom Sh.a”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**VENDIM**

**Nr. 70, Datë 11.01.2008**

**Mbi**

**“Autorizimin e përqendrimit të  
Bankës Credins Sh.A me BFSE Holding BV & SIFEM AG”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.01.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit në total të 25.4% të aksioneve të Bankës Credins respektivisht nga shoqëritë BFSE Holding (22.2%) dhe SIFEM (3.2%)

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit në Bankën Credins SHA nga shoqëritë BFSE Holding BV dhe SIFEM AG.

**V Ë R E N S E:**

**1. Palët në transaksion:**

- Balkan Financial Sector Equity Fund (**BFSE Holding BV**), me seli në Amsterdam, Hollandë, është blerësi i pjesës prej 22.2% të kapitalit aksionar të bankës Credins.

BFSE Holding BV e themeluar në prill të vitit 2007 sipas legjislacionit hollandez, bën pjesë në grupin me të njëjtin emër B.F.S.E Fund CV, nga i cili kontrollohet 100% në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet aksionerit të vetëm të saj me seli në Luksemburg, BFSE S.a.r.l.

BFSE Holding BV ushtron veprimtari financiare dhe manaxhimi, nëpërmjet pjesëmarrjes në shoqëri të tjera.

- Swiss Investment Fund for Emerging Markets (**SIFEM AG**), me qendër në Bernë, Zvicër, **blerësi** i pjesës prej 3.2% të kapitalit aksionar të Bankës Credins, është shoqëri aksionere, e themeluar në vitin 2005 sipas legjislacionit Zvicerian. Qëllimi i kësaj shoqërie është nxitja e sektorit privat të vëndeve në zhvillim dhe ekonomive në tranzicion me synim reduktimin e varfërisë dhe rritjen e nivelit të jetesës në këto vend, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të konsulencës afatgjata për zhvillimin e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme.
  - **Banka Credins** me qendër në Tiranë, Shqipëri, **shitësi** i pjesës prej 25.4% të kapitalit aksionar është shoqëri anonime themeluar sipas legjislacionit shqiptar, për kryerjen e veprimtarive bankare dhe financiare. Është pjesë e sistemit bankar, e licensuar nga Banka e Shqipërisë, me vendimin nr. 16, datë 31.03.2003.
2. Marrëveshja e nënshkruar nga palët (BFSE Holding BV, SIFEM AG dhe Bankës Credins), në datën 14 dhjetor 2007, ka për objekt shit-blerjen e aksioneve të Bankës Credins që në total përfaqësojnë 25.4 % të kapitalit dhe të së drejtës së votës. Në përfundim të këtij transaksioni, BFSE Holding BV do të zotërojë 22.2 % të aksioneve në bankën Credins dhe SIFEM AG do të zotërojë 3.2 %, ndërsa pjesa prej 74.6 % të aksioneve të mbetura të kapitalit aksionar të Bankës Credins Sh.A do të zotërohet nga 12 aksionerët e saj (që zotërojnë nga 0.79 % deri më 23.64 % të aksioneve).
  3. Transaksioni i përfuturit të kontrollit mbi një pjesë jo të konsiderueshme të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës, edhe pse nuk pritet të ndikojë në konkurrencën e tregut bankar, përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.
  4. **Për vitin 2006 xhiro:**
    - në tregun ndërkombëtar e SIFEM është 164 261 703 lekë; dhe
    - në tregun kombëtar e bankës Credins është 1 759 963 000 lekë.
  5. **Tregu Përkatës**
    - a) Tregu i produktit: **Shërbime bankare dhe financiare**
    - b) Tregu gjeografik: **Tregu kombëtar**
  6. **Vlerësimi i ndikimit në konkurrencë:**
    - Transaksioni konsiston në përfutimin e kontrollit në total të 25.4% të aksioneve të Bankës Credins. Në përfundim të këtij transaksioni, BFSE Holding BV do të zotërojë 22.2 % të aksioneve në bankën Credins dhe SIFEM AG do të zotërojë 3.2 %, ndërsa pjesa prej 74.6 % të aksioneve të mbetura të kapitalit aksionar të Bankës Credins Sh.A do të zotërohet nga 12 aksionerët e saj (pronësia fillon me 0.79 % deri më 23.64 %).

- Ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqëndrim ushtrojnë veprimtari financiare dhe bankare në tregje të veçanta gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët. BFSE Holding BV dhe SIFEM AG nuk janë të pranishme në tregun kombëtar me asnjë produkt apo investim. Gjithashtu, blerësit nuk janë të integruar vertikalisht dhe horizontalisht dhe nuk kanë asnjë lidhje midis tyre.
- Tregu është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohet nga ndryshime të shpejta përse i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjensi ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja dhe kjo, më e theksuar për qytetin e Tiranës.
- Përqëndrimi nuk sjell asnjë ndryshim në konkurrencë përse i përket strukturës së përgjithshme të tregut bankar dhe gjithashtu edhe në pjesë të veçanta të tij ku ushtron veprimtari Banka Credins ShA.
- Në këtë kontekst përqëndrimi nuk mund të ketë efekte antikonkurrense duke qënë se në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk rrezikon të krijojë pozitën dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim.

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

### VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit në Bankën Credins SHA nga shoqëritë BFSE Holding BV dhe SIFEM AG.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

### KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

( )

( )

( )

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 71 Datë 29.01.2008**

**Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs Gmbh (UNIQA).**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.01.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs Gmbh (UNIQA).

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs Gmbh (UNIQA)”,



## V Ë R E N S E:

### 1. Palët në transaksion:

1. UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH (UNIQA), është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me seli në Untere DonastrauBe, 1029, Viena, Austri, me veprimtari kryesore shërbimet në fushën e sigurimeve (sigurim jete, jo jete dhe risigurime). UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH është shoqëri bijë që zotërohet në mënyrë të tërthortë nga shoqëria mëmë Uniqa Versicherungen AG dhe shtrihet në Austri dhe në Europën qendrore e lindore, nëpërmjet pjesëmarrjes dhe manaxhimit në shoqëri të ndryshme në tregun e ofrimit të produkteve/shërbimeve të sigurimit/risigurimit.
  - Për vitin 2006, xhiro në tregun ndërkombëtar e 23165 mijë/Euro = 2850 milion/lekë.
  
2. Shoqëria “Siguracioni Shqiptar” (Sigal) Holding Sh.A, është themeluar sipas legjislacionit shqiptar në dhjetor 1999, me adresë Bulevardi Zogu I, Nr.1, Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me nr. 20863.
 

Shoqëria Sigal Holding sh.a është pjesë e tregut financiar shqiptar, e licensuar dhe mbikqyrur nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare. Sigal Holding sh.a, nëpërmjet filialeve të saj (24 degë) dhe 260 ndërmjetës në sigurime mbulon të gjithë territorin shqiptar dhe shtrihet edhe në Maqedoni (Sigal AD Shkup) dhe Kosovë (Sigal Sha-Drini dhe është aktive në fushën e sigurimit të jetës dhe jo-jetës, si dhe në produkte risigurimi.

Sigal Holding sh.a përbëhet nga dy shoqëri të sigurimit: Sigal sh.a dhe Sigal Life sh.a, të cilat i zotëron 100%, përveç një aksioni në secilën nga këto shoqëri që zotërohen nga UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH.

Struktura e aksioneve të SIGAL Holding sha është një bashkim, i kontrolluar nga 6 aksionerë, ku më i vogli zotëron 0.02% të aksioneve dhe më i madhi 45.01 % të aksioneve.

  - Për vitin 2006, xhiro në tregun ndërkombëtar e Sigal Holding A ( )Degët ose filialet në Maqedoni & Kosovë) është 9 milion 092 mijë Euro = 1118 milion/lekë; dhe
  - Xhiro totale në tregun kombëtar për vitin 2006 e Sigal Holding sha është 11 milion 206 mijë Euro= 1 378 milion lekë.
  
3. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin të një pjese të ndjeshme të kapitalit aksioner dhe të së drejtës së votës ( 45.62 %) të Sigal Holding sh.a nga UNIQA International Beteiligungs Verwaltungs GmbH (Uniqa), është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.
  
4. Në Marrëveshjen për Transferimin e Aksioneve të nënshkruar më datë 17.12.2007 mes shoqërisë Uniqa International dhe aksionarëve të Sigal Holding SH.A., në nenin 7 të saj, palët deklarojnë se shoqëria Sigal është një shoqëri që është themeluar dhe vepron sipas legjislacionit shqiptar. Aksionarët e kësaj shoqërie kanë pronësi të plotë mbi aksionet dhe se aksionet në shitje janë të lira nga çdo barrë dhe nuk janë subjekt falimentimi. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, shoqëria Uniqa bëhet mbartëse e të gjitha të drejtave

dhe detyrimeve që i takonin më parë aksionarëve shitës si pjesëmarrës në shoqërinë Sigal Holding SH.A. siç parashikohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

## II. Vlerësimi i Konkurrencës

### II.1 TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

#### II.1.a. Tregu i produktit:

Referuar Ligjit të gjitha shërbimet e ofruara apo përfuara nga konsumatorët në tregun përkatës, nga palët në këtë transaksion janë konsideruar produkte (kryeja e sigurimit të dëmeve në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti), sipas përcaktimit të licensave të lëshuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve):

- Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
- Sigurimet motorrike
- Sigurimi i avionëve, anijeve, marinës dhe transportit
- Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë
- Sigurimi i Përgjegjësive
- Sigurimi i Kreditit dhe Garancive

Pjesa e tregut në totalin e tregut të sigurimit të jo jetës që zë shoqëria SIGAL Holding sh.a është 27.34%, duke u renditur kështu në krye të këtij tregu; ndërsa pjesa e tregut të sigurimit të jetës është 35.14%, duke u renditur në vend të dytë me 35.14%, pas Insig-ut.

Për produktin dëme të paguara shoqëria Sigal Holding ShA renditet në vend të parë për dëmet e paguara në tregun e jetës, me pjesë tregu 59.77% dhe në vend të dytë, me pjesë tregu 25.28% në tregun e jo jetës, të ndarë sipas primeve të nënshkruara.

#### II.1.b. Tregu gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit. Por, duke qënë se pasojat e veprimtarisë së palëve do të ndihen direkt në tregun e brendshëm, në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar.

### II.2 STRUKTURA E TREGUT & KONKURRENTËT NË TREGUN KOMBËTAR

- Në tregun shqiptar të sigurimeve ushtrojnë veprimtarinë e tyre në total 10 shoqëri të sigurimeve, nga të cilat shtatë (7) në shërbimin e sigurimit të jo-jetës, dy (2) në sigurimet e jetës dhe një (1) në sigurimin e shërbimeve të jetës dhe jo-jetës së bashku. Tregu i sigurimeve për vitin 2006 realizoi një volum të primeve të shkruara bruto prej 4.5 miliard lekë dhe është i orientuar tek sigurimet e jo-jetës që zënë

93% të volumit të përgjithshëm të primeve dhe vetëm 7% tek e sigurimet e jetës. Ndërsa, volumi i primeve të shkruara në sigurimin e Jetës ishte 307.517 mijë lekë, të realizuara nga tre shoqëri që veprojnë në këtë treg (Insig, Sigal Life, Sicred).

- Konkurrentët kryesorë të Sigal Holding sh.a janë, Insig me 18.64 për qind të tregut, Sigma që zotëron 18.40 për qind të tregut ndërkohë që më pak pjesë tregu kanë shoqëritë e tjera të sigurimeve, si Atlantik me 11.39%, Intersig me 8%, Interalbani 7.05%, Albsig 5.95% dhe Eurosig 3.23%.
- Tregu i sigurimeve është një treg në zhvillim, që karakterizohet nga ndryshime të shpejta, pa barriera hyrëse, me prezencë të konkurrentëve të fortë, kryesisht në tregun e sigurimit të detyrueshëm dhe mbikëqyret nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar dhe kryer hetime në këtë treg si dhe është shprehur me anë të disa vendimeve me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e sigurimeve.
- Tregu i sigurimeve është mesatarisht i përqendruar në sigurimet motorrike dhe shumë i përqendruar në sigurimin e pasurisë. Shoqëria Sigal Holding Sh.A zë vendin e parë në këto tregje.
- Palët pjesëmarrëse në përqëndrim megjithëse ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel tregu produkti dhe kanë një marrëdhënie horizontale, veprojnë në tregje të veçanta gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët.
- Palët pjesëmarrëse nuk janë të integruara vertikalisht në shoqëri të tjera sigurimi, risigurimi dhe ndërmjetsimi në tregun e brendshëm.
- Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të paketës prej 45.62 % të Sigal Holding sh.a nga UNIQA International Beteiligungs Verwaltungs GmbH (Uniqa), rritjen dhe forcimin e pozicionit të këtij aksioneri (që para transaksionit ishte në minorancë me 0.02% të aksioneve) dhe nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve. Indeksi i përqendrimit (HHI) nuk ndryshon edhe pas realizimit të përqendrimit.
- Rritja e investimit të huaj, nëpërmjet përfimit të kontrollit në shoqërinë Sigal Holding Sh A pritet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e tregut, rritjen e numrit dhe cilësisë së produkteve, përmirësimin e standarteve të ofrimit të shërbimit, duke mos kufizuar por duke rritur konkurrencën në të gjithë tregun apo në pjesë të veçanta të tij, duke sjellë kështu përfitime për klientët.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar i kontrollit të paketës prej 45.62 % të Sigal Holding sh.a nga UNIQA International Beteiligungs Verwaltungs GmbH (Uniqa), nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të sigurimeve.

Në këtë kontekst ky përqëndrim nuk shkakton efekte antikonkurrese, dhe në kuptim të nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk krijon pozitë dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim, Pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqëndrimi dhe krijimit të pozitës dominuese.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë, përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të 45.62% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigal Holding Sh.A nga shoqëria UNIQA International Beteiligungs-Verwaltungs GmbH (UNIQA).”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për publikimin e e autorizimit dhe njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar(\_\_\_\_\_)  
Anëtar(\_\_\_\_\_)  
Anëtar**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 72 Datë 19.02.2008**

**Për**

**Rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative  
në fushën e energjisë**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2008 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Kundërshtitë ligjore me rrjedhojë deformimin e tregut në fushën e prodhimit dhe shitjes të energjisë elektrike.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenet 24, shkronjat d dhe f, 69 dhe 70.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të ankesës së Shoqatës së Prodhuesve Privatë të Energjisë Elektrike (SHPPE), informacionit të Drejtorisë së Mbikqyrjes së Tregut, si dhe administrimit të akteve shkresore,

**V Ë R E N S E:**

1. Tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes së energjisë elektrike karakterizohet si një treg me një përqendrim të lartë, i dominuar ndjeshëm nga një ndërmarrje, KESH Sh.A.
2. Në tregun e prodhimit, përveç KESH Sh.A ushtrojnë veprimtarinë e tyre private 10 operatorë të licensuar, nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE), për prodhim

energji elektrike në burimet hidroenergjetike me fuqi deri në 10 MW. Nga këta: 6 operatorë zotërojnë të drejtën e pronësisë nëpërmjet kontratave konçensionare dhe 4 të tjerë i zotërojnë ato plotësisht (nëpërmjet privatizimit). Veprimtaria e KESH sh. a dhe operatorëve të vegjël mbikqyret nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

3. Sasia e energjisë elektrike e prodhuar dhe e shitur nga prodhuesit privatë të energjisë, nëpërmjet KESH sh.a, është shumë e vogël dhe pothuajse e pandjeshme në krahasim me sasinë e energjisë që prodhon vetë KESH sh.a. Në vitin 2007 sasia e prodhuar dhe e shitur nga këto operatorë privatë (të privatizuar dhe të dhënë me konçension) zë 1.82% të prodhimit të KESH sh.a, ndërsa në vitin 2006 zinte 1.12% të prodhimit të KESH sh.a.
4. Tregu i energjisë elektrike është treg i rregulluar, por jo i liberalizuar. ERE ka për detyrë funksionale rregullimin teknik dhe ekonomik në funksionimin e tregut, zgjerimit, hyrjes së operatorëve të rinj, heqjes së barrierave dhe sigurimin e konkurrencës. Përgjegjësitë dhe rregullat për vendosjen e tarifave janë përcaktuar përkatësisht në nenet 8 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2006 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
5. Në zbatim të funksioneve të saj, ERE ka miratur dy Vendime lidhur me metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et me fuqi deri në 10 MW, përkatësisht:

Vendimin Nr 5, datë 26.1.2007 ku çmimi i shitjes së energjisë elektrike është llogaritur mbi bazën e kostos, për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

Vendimin nr. 24, datë 11.04.2007 ku çmimi i shitjes të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW, llogaritet mbi bazën e çmimit të importit. Theksojmë se ky vendim nuk është zbatuar, mbasi nuk ekziston asnjë investitor konçensionar për ndërtimin e HEC –ve të reja me fuqi të instaluar deri në 10 MW.

Baza ligjore ku ERE është mbështetur për nxjerrjen e dy vendimeve buron nga dy ligje të ndryshme dhe konkretisht:

6. Vendimi nr 5, datë 26.01.2007, është nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2006 “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 26, pika 1 dhe nenit 28 “Rregullat për vendosjen e tarifave”. Për llogaritjen e çmimit unik sipas metodologjisë të miratuar me këtë vendim, merret në konsideratë çmimi mesatar i shitjes me pakicë të energjisë elektrike tek klientët tarifor në shpërndarje.
7. Vendimit nr.24, datë 11.04.2007, është nxjerrë në zbatim të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për Konçensionet”, nenit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçensioneve”, Kreu IV, pika 1, Llogaritja e çmimit sipas metodologjisë të miratuar me këtë vendim, bëhet mbi bazën e çmimit të energjisë së importuar.
8. Kostoja e prodhimit të energjisë së prodhuar nga HEC-et e privatizuar e llogaritur nga ERE dhe e shitur nëpërmjet një tregu të garantuar që është KESH ShA, rezulton e ulët, pasi për prodhimin e saj nuk ka kosto shtesë për investime dhe shpenzime.
9. Ndërsa, çmimi i përcaktuar mbi bazën e çmimit të blerjes nga importi (metodologjia sipas vendimit nr.24, datë 11.04.2007), bazohet mbi çmimin e blerjes së energjisë së importuar, është një çmim atraktiv për investitorët e huaj që duan të investojnë në fushën e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri, por zbatimi i tij shkakton

deformime të konkurrencës dhe diskriminim të operatorëve ekzistues në këtë treg. Aktualisht zbatimi i kësaj metodologjie është në potencë.

10. Çmimi i shitjes i llogaritur sipas metodologjisë me bazë koston, rezulton më i ulët se sa çmimi i llogaritur mbi bazën e çmimit të energjisë së importuar.
11. Ekzistenca dhe zbatimi i dy Vendime të mësipërme mbi metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et me fuqi deri në 10 MW, në kuptim të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, deformon tregun, duke i vendosur operatorët në kushte të pabarabarta dhe pafavorëshme konkurrence.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, shkronjat d dhe f, 69 pika 2 dhe 70 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

### **I REKOMANDON:**

#### **Entit Rregullator të Energjisë Elektrike**

1. Shfuqizimin e dy Vendimeve, përkatësisht, Nr 5 datë 26.1.2007 dhe Nr 24 datë 11.04.2007.
2. Unifikimin e metodologjive për përcaktimin e çmimit të shitjes për energjinë e prodhuar nga HEC-et me fuqi deri në 10 MW, si për ata ekzistues edhe për të rinjtë që do jepen me konçension, duke respektuar kërkesat e ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(                    )  
Zv/Kryetar

(                    )  
Anëtar

(                    )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**V E N D I M**

**Nr. 73 Datë 29.02.2008**

**Për Miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007 dhe objektivat për 2008”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.02.2008, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretarja e Përgjithshme të titulluar „Raporti Vjetor i veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007 dhe objektivat për 2008“. Bazuar në nent 24, germa e, dhe 29, germa ç, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretarja e Përgjithshme,

**VENDOSI:**

Te miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007 dhe objektivat për 2008” sipas Raportit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali  
 (\_\_\_\_\_)
   
Zv/Kryetar

Servete Gruda  
 (\_\_\_\_\_)
   
Anëtar

Koço Broka  
 (\_\_\_\_\_)
   
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

**K R Y E T A R E**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 74 Datë 11.03.2008**

**Për**

**Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.03.2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg.

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d), neni 26, dhe neni 43  
Ligji Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 47 pika 2.

Raportit “Mbi Hetimin e Përgjithshëm në Sektorin e Energjisë” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës,

**V Ë R E N S E:**

Në përfundim të hetimit të përgjithshëm të realizuar në Sektorin e Energjisë vërehet se, ka një përqendrim mesatarisht të lartë të tregut të shumicës nga disa operatorë, si dhe integrim vertikal i tyre. Sjellja e cmimeve në këtë treg nuk i përgjigjet sjelljes së cmimeve në tregjet furnizuese ndërkombëtare. Tregu mund të karakterizohet nga një konkurrencë e kufizuar e shkaktuar nga firmat me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës.

**PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nenit 47 pika 2 e Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

**VENDOSI:**

1. Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurës së hetimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më 11.03.2008

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

( )  
Zv/Kryetar

( )  
Anëtar

( )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**KRYETARE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 75 Datë 21.03.2008**

**Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 51% të kapitalit të shoqërisë Trema Engineering 2 Shpk te shoqëria Strabag SE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 51% të aksioneve të shoqërisë „Trema Engineering 2“ Shpk te shoqëria “Strabag SE”

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të kapitalit 51% të shoqërisë Trema Engineering 2 Shpk te shoqëria Strabag SE”

**V Ë R E N S E:**

**I. Palët në transaksion:**

**Trema Engineering 2** sh.p.k, me seli në Tiranë, është krijuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, zotërohet nga një ortak i vetëm. Trema Engineering 2 shpk, **shitësi** i pjesës prej 51%

të kapitalit, ushtron veprimtarinë në tregun e ndërtimeve civile dhe projektimit. Ilir Trebicka si person fizik, ka pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë në disa shoqëri që ushtrojnë veprimtari në tregje të ndryshme nga tregu i ndërtim projektimit, si në: tregun e import-eksportit, përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të gazit, naftës dhe nënprodukteve të tyre; tregun e shitjes dhe/ose prodhimit, transformimit, tregtimit dhe aplikimit të lëndëve çimentore të papërziara, ose të ndonjë natyre tjetër, izolues në gjëndje të lëngët, rezina, detergjentë etj; tregun e sigurimit dhe ofrimit të shërbimeve të parkimit me pagesë dhe shërbimit taksi.

Për vitin 2006, xhiro në tregun kombëtar është **2 335 388 811 lekë**

Shoqëria “**Strabag SE**” është një shoqëri e themeluar dhe e organizuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Austrisë, me seli në Villach, Austri, regjistruar në regjistrin tregtar në Klagenfurt. Strabag SE është pjesë e grupit me të njëjtin emër që ushtron veprimtarinë e vet në tregun e shërbimeve të ndërtimit në Evropën Qendrore dhe Lindore si në: Austri, Gjermani, Republikën Çeke, Sllovaki, Hungari, Poloni dhe Rumani.

Veprimtaria e Strabag Group përfshin: (i) **Ndërtim dhe Projektim** ku përfshihen ndërtime godinash për qëllime tregtare dhe industriale, zyra dhe ndërtesa publike, ndërtime rezidenciale dhe hotele, etj., tregtim i impianteve të energjisë elektrike, projekte urash, mole, hekurudhash, teknologji mjedisore etj. (ii) **Ndërtim rrugësh**; (iii) **Hapja e tuneleve dhe shërbime**.

Strabag SE në vitin 2006 ka qënë e pranishme në tregun kombëtar, nëpërmjet degës së saj në ndërtime civile, konkretisht në ndërtimin e ujësjellsit në Pogradec.

Për vitin 2006<sup>1</sup> xhiro e shoqërisë Strabag:

Në tregun kombëtar **1 917 000 Euro ose 235 791 000 lekë<sup>2</sup>**.

Në tregun ndërkombëtar është **9 430 621 000 Euro ose 1 159 966 383 000 lekë**.

Marrëveshja e nënshkruar nga palët (Trema Engineering 2 shpk si “Shitësi” dhe Strabag SE- Blerësi), ka për objekt shit-blerjen e 156 451 aksione, të barabarta me 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë Trema Engineering 2 shpk tek Strabag SE.

Ky transaksion, që përbën përfitim të kontrollit të një pjesë të kapitalit dhe të së drejtës së votës, është një përqendrim që përmbush kushtet për të qënë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

## II. Vlerësimi i Konkurrencës

### II.1 TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

**II.1.a** Tregu i produktit për Trema Engineering 2 shpk përfshin produktet në tregun e projektimit dhe të zbatimit, sipas nënndarjeve të përcaktuara në licensën Nr 4070/3 Projektim: Studime pjesore Urbanistike, projektim konstruksione b/a, metalike, massive

<sup>1</sup> Bilancet e konsoliduara të vitit 2007 nuk janë publikuar ende deri në momentin e njoftimit të përqëndirimit

<sup>2</sup> Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë

guri, druri, vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkimi, kulla ekuilibri, porte e pontile, rruge auto kategoria V dhe VI, projektim rruge kategoria III dhe II-I, projektim shtrese rrugore e sistemim asfaltim, autostrada, pista, aeroporte dhe heliporte, projektim ura dhe vepra arti deri 10 m, ura metalike të varura.

Zbatim: Gërmime dheu me punime eventuale muratore e beton arme, prishje dhe punime në tokë të gërmuar, rodhim material inerte-gure, prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshme - gurë dekorativë, prodhim materiale me bazë bitumi-sintetik, ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime rrugore, ndërtim ura dhe vepra arti, ndërtim ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje sillosa, kulla uji etj. prej b/a – metalike, përforcim themeli, izolime mbi dhe nëntokësore nga ujërat, themele të veçanta.

Pjesa e tregut të Trema Engineering 2 shpk ndaj totalit të tregut kombëtar të produktit (ndërtim-projektim) është rreth 1.5 %.

**II.2.a** Veprimtaria e Strabag Group përfshin: (i) **Ndërtim dhe Projektim** ku përfshihen ndërtime godinash për qëllime tregtare dhe industriale, zyra dhe ndërtesa publike, ndërtime rezidenciale dhe hotele, etj tregtim i impianteve të energjisë elektrike, projekte urash, mole, hekurudhash, teknologji mjedisore etj. (ii) **Ndërtim rrugësh**; (iii) **Hapja e tuneleve dhe shërbime**.

Ndarja e të ardhurave të tre grupeve kryesore të produktit të shoqërisë Strabag SE ndaj xhiros totale të saj është është:

Ndërtime civile dhe ekonomike **47.8%** .

Ndërtim rrugësh **45.4%**

Ndërtim tunelesh dhe shërbime **6.8%**

**II.3.b** Tregu gjeografik:

**Trema Engineering 2** shpk ushtron veprimtari në një treg të kufizuar gjografik (në Tiranë dhe Vlorë) brenda tregut kombëtar.

**Strabag SE** ushtron veprimtari në tregun ndërkombëtar kryesisht në ; Austri, Gjermani, Hungari, Çeki, Poloni, Sllovaki, Kroaci, Rusi, Slloveni, Rumani, Bullgari, Serbi, Mal i Zi, Zvicër, Vendet e Beneluks etj..

Palët veprojnë në tregje gjeografike të veçanta dhe nuk kanë klientë të përbashkët. Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura sipas seksionit 6(III) të “Formularit të Njoftimit të Përqëndrimit”, nuk ka tregje të prekura nga përqëndrimi i njoftuar.

### **III. Struktura e tregut dhe konkurrentët në tregun kombëtar**

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të Trema Engineering 2 shpk -Shitësit në favor të Blerësit Strabag SE që është dhe pala njoftuese, nuk ndryshon strukturën e tregut shqiptar të ndërtimit, pasi ky ndryshim lidhet vetëm me ndryshimin e strukturës së aksioneve brenda shoqërisë Trema Engineering 2 shpk. Pjesa e tregut të njësisë së re (që ruan atë emër) ndaj tregut të ndërtim-projektim mbetet 1.5 %, ndërsa pjesa e tregut për ndërtime civile mbetet 5%.

Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura<sup>3</sup> nuk ka tregje të prekura nga përqëndrimi i njoftuar. Palët pjesëmarrëse në përqëndrim megjithëse ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel

tregu produkti, veprojnë në tregje të veçanta gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët.

Palët pjesëmarrëse kanë pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë në disa shoqëri që ushtrojnë veprimtari në tregje të ndryshme nga tregu i ndërtim projektimit.

Transaksioni nuk ndryshon strukturën e tregut të ndërtimit në përgjithësi, si dhe as në tregun e produkteve. Hyrja e një shoqërie europiane me mjaft eksperiencë në këtë fushë) pritet të rrisë konkurrencën në treg, duke rritur cilësinë mbi bazën e standarteve europiane.

Pavarësisht sa sipër, Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë në vazhdimësi tregun e e ndërtimeve civile, për shkak të pjesëve të tregut që zotërojnë shoqëritë dhe të ndryshimeve të mundshme në strukturën e tij.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar i përfundimit të kontrollit të paketës prej 51 % të Trema Engineering 2 shpk nga Strabag SE nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e përgjithshme të tregut shqiptar të ndërtimit dhe në veçanti të tregut të ndërtimeve civile.

Në këtë kontekst ky përqëndrim nuk shkakton efekte antikonkurrese dhe në kuptim të nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk krijon pozitë dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqëndrim, pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqëndrimi dhe krijimit të pozitës dominuese.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë, përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të 51% të kapitalit të shoqërisë Trema Engineering 2 shpk nga shoqëria Strabag SE, me qendër Austri.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për publikimin e autorizimit dhe njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

**K R Y E T A R E**

<sup>3</sup> Sipas seksionit 6(III) të “Formularit të Njoftimit të Përqëndrimit”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**V E N D I M**

**Nr. 76 Datë 07.04.2008**

**Për Miratimin e Udhëzimit “Për Përcaktimin e Tregut Përkatës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07/04/2008, në zbatim të nenit 24 gërma dh), si dhe nenit 3, pika 7, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm, në kuadër të përmirësimit dhe përafrimit të legjislacionit vendas të konkurrencës me atë të BE-së:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Udhëzimit “Për Përcaktimin e Tregut Përkatës“, sipas formës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më datë 07/04/2008

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali  
( )  
Zv/Kryetar

Servete Gruda  
( )  
Anëtar

Koço Broka  
( )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**

---

**UDHËZIM**

**Nr. Datë . .2008**

**“Për Përcaktimin e Tregut Përkatës”**

**I. Qëllimi**

- 1) Qëllimi i udhëzimit është të shpjegojë tregun përkatës, të ndarë në tregun përkatës të produktit dhe tregun përkatës gjeografik.
- 2) Koncepti i “tregut përkatës” është i ndryshëm nga përcaktimet e tjera të tregut, shpesh të përdorura në këtë kontekst. Për shembull, ndërmarrjet shpesh përdorin termin “treg” për t’iu referuar zonës ku shiten produktet e tyre ose për t’iu referuar më gjerë industrisë apo sektorit ku ato bëjnë pjesë.
- 3) Sipas nenit 3 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar): “Treg përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrencë, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese”.
- 4) Përcaktimi i tregut është një instrument për të identifikuar, përcaktuar dhe analizuar nivelin e konkurrencës ndërmjet ndërmarrjeve. Tregu përkatës përfshin produktin ose grupin e produkteve po kështu dhe Zonën Gjeografike, ne te cilën këto mallra/shërbime janë prodhuar dhe/ose tregtuar.
- 5) Përcaktimi i tregut përkatës si në atë të produktit dhe në atë gjeografik ka një ndikim vendimtar në vlerësimin e konkurrencës. Duke i bërë publike procedurat që Autoriteti ndjek kur përcakton përkufizimin e tregut dhe duke treguar kriteret dhe evidencat mbi të cilat mbështetet për të arritur në një vendim, rrit përgjegjshmërinë dhe transparencën e politikës dhe vendim – marrjes së tij.
- 6) Rritja e transparencës ndikon mbi ndërmarrjet duke i bërë më të afta të marrin pjesë në përpjekjet e Autoritetit, me qëllim rritjen e konkurrencës efektive në një rast konkret. Ndërmarrjet mund të marrin parasysh një mundësi të tillë në vendimmarrjen e tyre të brendshme kur parashikojnë p.sh. blerje ose shitje të aksioneve apo pjesëve të pronësisë, bashkimin ndërmjet tyre, krijimin e “joint ventures”, ose nënshkrimin e marrëveshjeve të caktuara.



- 7) Është gjithashtu e parashikuar që ndërmarrjet duhet të jenë në një pozicion më të mirë për të kuptuar se çfarë lloj informacioni Autoriteti konsideron si me të përshtatshëm për qëllimet e përcaktimit të tregut.
- 8) Objektivi i përcaktimit të tregut si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, është identifikimi i konkurrentëve aktualë dhe potencialë të ndërmarrjeve që janë të përfshirë në atë treg, sjelljen e këtyre ndërmarrjeve, si dhe ato ndërmarrje që kanë mundësinë të kufizojnë konkurrentët dhe sjelljen e tyre te pavarur ndaj presionit konkurrues efektiv.
- 9) Përcaktimi i tregut përkatës bën të mundur “inter alia” llogaritjen e pjesëve të tregut, përcaktimin e fuqisë së ndërmarrjes, strukturës së tregut me qëllim vlerësimin e konkurrencës në këtë treg.

## II. Përcaktimi i tregut përkatës.

### II.1. Përcaktimi i tregut përkatës të produktit dhe atij gjeografik

- 10) Ekzistojnë dy dimensione për përcaktimin e tregut: dimensionin e produktit dhe dimensionin gjeografik. Produktet që duhet të përfshihen në tregun përkatës dhe kufijtë gjeografikë të atij tregu, përcaktohen në varësi të hapësirës në të cilën klientët mund të zgjedhin shumë lehtë midis produkteve të zëvendësueshme, ose furnitorët mund të kenë më të lehtë furnizimin e këtyre produkteve alternative. Çelësi për përcaktimin e tregut është zëvendësueshmëria.
- 11) Tregu përkatës brenda të cilit vlerësohet një rast i caktuar konkurrence është përcaktuar si një kombinim i tregjeve përkatëse të produkteve dhe atyre gjeografike. Për përcaktimin e tregut përdoret testi SSNIP (Small But Not Significant Non-transitory Increase in Price) ose ndryshe Testi i Monopolistit Hipotetik. Në përdorimin e testit SSNIP për të përkufizuar tregun e produktit, do të duhet të gjejmë se, kur një monopolist hipotetik i një lloji të caktuar produkti apo një sërë produktesh, të cilat duhet të përbëjnë një treg, mund të imponojë një rritje domethënëse jo tranzitore por të vogël në çmim (SSNIP). Hapi i parë i testit është të analizohen karakteristikat e produkteve, duke përfshirë qëllimin që këto do të përdoren në mënyrë që të gjenden zëvendësuesit e mundshëm, të cilët mund të përfshihen në përcaktimin e tregut përkatës. Hapi i dytë shqyrton se çfarë ndodh atëherë kur çmimi relativ i këtyre prodhimeve të zëvendësueshme rritet. Testi SSNIP zakonisht është konceptuar se pretendon një rritje të çmimeve për grupin e produkteve në fjalë në një nivel prej 5 – 10%, ndërsa të gjitha çmimet e tjera mbeten të pandryshuara. Madhësia absolute e rritjes së çmimeve e përdorur në test do të jetë në varësi të rrethanave të hetimit, por në përgjithësi praktika e ndjekur do të jetë rritja hipotetike me rreth 5 %, ndërkohë që pretendohet që çmimet e tjera mbeten të pandryshuara, deri në një vit. Në shumë shembuj, një rritje e çmimit të produkteve me rreth 5 % (dhe çmimet e tjera të pandryshuara) në mënyrë të arsyeshme pritet t'i bëjë klientët të rishikojnë vendimet për blerjet, duke sjellë kështu një nivel efektiv gjatë të cilit merret parasysh testi. Një rritje prej 5 % çmimesh pritet gjithashtu të ketë një efekt të ndjeshëm mbi kufirin e fitimit të ndërmarrjes, qëllimi kryesor është në qoftë se kërkesa do të reduktohet në një hapësirë të tillë aq sa të kompensojë efektin e kufirit më të lartë.
- 12) Tregu përkatës i produktit sipas të Drejtës Evropiane të Konkurrencës përcaktohet si: “Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të

cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të produktit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”. Tregu Përkates përcaktohet si tregu në të cilin një ose me shumë të mira konkurrojnë mes tyre. Këto “të mira” do duhet të jenë të ngjashme, në mënyre që ato të merren në konsideratë nga konsumatorët ose përfituesit kur ata vendosin për të blerë. Identifikimi i tregut përkatës të produktit kërkon paraprakisht një analizë, e cila do të marrë në konsideratë faktorë të tillë thelbësorë si: zëvendësueshmëria, konkurrenca, çmimet, elasticiteti i kërkesës së mallit në varësi të çmimeve të prodhimeve të tjera, etj. Që dy prodhime të konsiderohen nga blerësit si të zëvendësueshëm ose të këmbyeshëm, nuk është kusht që ata duhet të jenë të njëjtë nga pikëpamja e karakteristikave të tyre fizike dhe funksionale, çmimeve ose cilësisë. Përkundrazi, përcaktuese në këtë rast është një shkallë e mjaftueshme e zëvendësueshmërisë të tyre për të kënaqur nevojat dhe dëshirat e blerësve, me synimin që secili nga këto prodhime të mund të përbëjë një alternative reale ekonomike për prodhimin tjetër, e që konsumatori të mund të zgjedh kur të vendosi për të blerë. Për këtë grup prodhimesh, të konsideruara si të zëvendësueshme nga blerësit dhe që përbën, (nga këndvështrimi i kërkesës) tregun e produktit do të duhet ti shtohen edhe prodhimet, të cilat nuk janë aktualisht të zëvendësueshme nga këndvështrimi i kërkesës, por nga këndvështrimi i ofertës. Këtu duhet pasur parasysh rasti i prodhimeve, të cilat mund të prodhohen lehtësisht dhe ekonomikisht, duke qenë të pranueshme nga disa prej prodhuesve, e që çojnë në rritjen e kapacitetit dhe gamës së mallrave të tyre ekzistuese. Kjo, me synimin që këto mallra të mund të bëhen, brenda një periudhe të arsyeshme, zëvendësues për prodhimet tashme të përfshira në Tregun Përkates të Produktit. Këto parime zbatohen gjithashtu dhe për rastin e shërbimeve.

- 13) Tregu përkatës gjeografik përcaktohet nga kjo pikëpamje si: “Një treg përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene dhe që mund të dallohen nga zona fqinje sepse kushtet e konkurrencës janë vlerësuar të ndryshme në këto zona”. Elementet, të cilët duhet të merren në konsideratë kur përcaktojmë Tregun Gjeografik, përmbledhin:
- natyrën dhe karakteristikat e prodhimeve përkatëse;
  - ekzistencën e pengesave të hyrjes;
  - parapëlqimet e konsumatorëve;
  - dallimet ndërmjet pjesëve të tregut të ndërmarrjeve, në zonat gjeografike fqinje; si edhe
  - ndryshimet thelbësore ndërmjet çmimeve të ofruesve dhe nivelet e kostove të transportit.

Faktorët e mësipërm përcaktojnë Tregun Gjeografik, në të cilin janë vendosur prodhuesit konkurrues.

- 14) Për të vërtetuar nëse i përkasin të njëjtit Treg Përkates ose jo, nuk është e nevojshme që mallrat të prodhohen në të njëjtin vend ose në një vend fqinje. Me rëndësi është fakti që, të gjithë këto mallra/shërbime duhet të jenë të vlefshme për të njëjtën kategori blerësisht, p.sh. secili nga këta të jetë një alternativë reale ekonomike për të tjerët. Për disa prodhime tregu përkatës gjeografik mund të jetë një pjesë e ndarjes administrative (Bashki, Komunë, Qark), tërësia e Ndarjes Administrative, vetë

shteti, Rajoni përfshirës i Shtetit, pra një zone e Shqipërisë, ndërsa për prodhime të tjera gjithë tërësia gjeografike e vendit.

## II.2 Koncepti i tregut përkatës dhe objektivat e Politikës Kombëtare të Konkurrencës.

- 15) Koncepti i tregut përkatës është i lidhur ngushtë me objektivat e Politikës Kombëtare të Konkurrencës. P.sh:
  - a. Objektivi i procedurave të kontrollit të përqendrimeve për ndryshimet e strukturës së tregut të produktit është të parandalojë krijimin ose forcimin e pozitës dominuese si rezultat i së cilës, konkurrenca efektive do të kufizohet në mënyrë të ndjeshme, në të gjithë tregun ose një pjesë të konsiderueshme të tij.
  - b. Autoriteti heton dhe ndalon abuzimin me pozitën dominuese ku vetë pozita dominuese do të përcaktohet duke iu referuar tregut përkatës.
- 16) Kriteret për përcaktimin e tregut përkatës zbatohen për analizat e sjelljeve të ndryshme të konkurrentëve në treg dhe ndryshimeve strukturore të tregut. Kjo analizë mund të çojë në rezultate të ndryshme që varen nga natyra e çështjeve të konkurrencës të marra në shqyrtim. P.sh. qëllimi i përcaktimit të tregut gjeografik mund të jetë i ndryshëm për produkte të njëjta në kohë të ndryshme në varësi të qëllimit për të cilin analizohet ky treg (p.sh. një përqendrim ose një analizë e sjelljes së ndërmarrjeve në një periudhë të mëparshme).

## III. Parimet bazë për përcaktimin e tregut.

### III.1. Kufizimet e konkurrencës.

- 17) Konkurrenca i vendos ndërmarrjet përpara tre kufizimeve kryesore, si: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës, zëvendësueshmëria nga ana e ofertës dhe konkurrenca potenciale. Nga një këndvështrim ekonomik për përcaktimin e tregut përkatës, zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës përbën detyrimin disiplinor më efektiv dhe më të domosdoshëm mbi ofruesit e një produkti të caktuar, në veçanti në lidhje me vendimet e tyre për çmimet. Një ndërmarrje ose grup ndërmarrjesh nuk mund të ketë një ndikim të ndjeshëm mbi kushtet ekzistuese të shitjes, të tilla si çmimi, n.q.s konsumatorët e tyre do jenë në gjendje të ndërrojnë lehtësisht me produkte të zëvendësueshme të disponueshme, ose për ofertuesit që gjenden në një vend tjetër. Në parim, ushtrimi i përcaktimit të tregut konsiston në identifikimin e burimeve alternative efektive të ofertës për konsumatorët e ndërmarrjes së përfshirë, si në termat e produkteve ashtu dhe të vendndodhjes gjeografike të ofruesve.
- 18) Kufizimet e konkurrencës si pasojë e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, si dhe nga konkurrenca potenciale, janë në përgjithësi më pak imediate dhe në çdo rast kërkojnë një analizë të faktorëve shtesë. Si rezultat, të tilla kufizime janë marrë në konsideratë në fazën e vlerësimit të analizës së konkurrencës.

### III.2 Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës

- 19) Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh sepse një rritje e çmimeve e bën

një produkt më pak të pëlqyer nga klientët, të cilët vendosin të blejnë më pak nga ai dhe më shumë nga produktet alternative zëvendësuese. Një njësi matëse formale e zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, i njohur si elasticitet, shikon se si reagon kërkesa ndaj ndryshimit të çmimit, kur të gjitha çmimet e tjera mbeten të pandryshuara.

- 20) Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës ndodh kur konsumatorët këmbëjnë një produkt me një tjetër, në përgjigje të ndryshimeve në çmimin përkatës të produkteve. N.q.s blerësit janë në gjendje të këmbëjnë produkte të gatshme dhe të zëvendësueshme ose fillojnë të kërkojnë burime të tjera për kërkesat e tyre, nga ofrues të vend-ndodhur në zona të tjera, atëherë është e pamundur që rritja e çmimeve të jetë me përfitim. Vlerësimi i zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës kërkon një përcaktim të gamës së produkteve, të cilat shikohen si të zëvendësueshme nga konsumatori. Një mënyrë e këtyre përcaktimeve mund të shihet si një eksperiment spekulativ, duke marrë të mirëqenë një çmim hipotetik, relativisht të vogël duke ruajtur ndryshimet dhe duke vlerësuar reagimet e mundshme të konsumatorëve ndaj kësaj ngritjeje. Ushtrimi i përcaktimit të tregut përqendrohet tek çmimet për qëllime operationale dhe praktike dhe më ekzaktësisht, mbi zëvendësueshmërinë e kërkesës që vjen nga ndryshimet e vogla e të vazhdueshme në çmimet relative. Ky koncept mund të sigurojë tregues të qartë për evidencat përkatëse në përcaktimin e tregut. Kjo lidhet me konceptin e Elasticitetit të Çmimeve. Vlerësimi i Elasticitetit të Çmimeve nga ana e kërkesës kryhet nëpërmjet testit SSNIP (Small But Not Significant Non-transitory Increase in Price).
- 21) Në koncept, ky afrim nënkupton që, duke filluar nga lloji i produktit që ndërmarrjet e përfshira dhe zona në të cilën ato shesin, produktet dhe zona të tjera shtesë mund të përfshihen ose përjashtohen nga përcaktimi i tregut në varësi nga fakti nëse konkurrenca nga këto produkte të tjera dhe zona shtesë ndikon ose kufizon mjaftueshëm konkurrencën nëpërmjet çmimeve të produkteve të palëve në terma afatshkurtra.
- 22) Çështja që shtrohet është të dimë reagimin: n.q.s klientët e palëve do të ndryshonin produktet me zëvendësues të gatshëm në zonat të tjera, në përgjigje të një çmimi hipotetik të ulët (në një interval nga 5% te 10%), dhe relativisht të qëndrueshëm.
- 23) Një shembull praktik i këtij testi mund të sigurohet nga zbatimi i tij tek një përqendrim p.sh. për shishet e pijeve jo-alkoolike. Një çështje për tu shqyrtuar do të ishte të vendosej n.q.s. lloje të ndryshme shishesh të pijeve joalkoolike i përkasin të njëjtit dhe vetëm një tregu. Në praktikë, pyetja që do të drejtohej do të ishte n.q.s. konsumatori i shijes A do ta ndërronte me shije tjetër, kur ballafaqohet me një rritje permanente çmimi për shijen A nga 5% tek 10%. N.q.s. një numër i mjaftueshëm i konsumatorëve do të ndërronin p.sh. le të themi shijen B deri tek ajo pikë që çmimi rritet për shijen A, nuk do të ishin me përfitim zotërimet që rezultojnë nga humbja e shitjeve, dhe atëherë tregu do të përfshijë të paktën shijet A dhe B. Procesi do të shtrihet në lidhje me shije të tjera të disponueshme deri sa një grup i produkteve të identifikohet me një rritje të tillë çmimi, i cili nuk do të ndikonte në një zëvendësim të mjaftueshëm në kërkesë.
- 24) Në përgjithësi, dhe në veçanti për analizat e rasteve të përqendrimeve, çmimi që do të merret në konsideratë do të jetë një çmim tregu ekzistues. Ky mund të mos jetë rasti

ku çmimi ekzistues është përcaktuar në kushtet e një konkurrence të pamjaftueshme. Në veçanti për hetimet e abuzimit me pozitën dominuese, fakti që çmimi ekzistues mundet të jetë rritur ndjeshëm, do të duhet të merret në konsideratë.

- 25) Informacionet që përdoren për të parë mundësinë e zëvendësimit nga ana e kërkesës janë: informacion se çfarë ndryshime çmimesh janë bërë në kohë, karakteristikat e produkteve, informacion i klientëve për konkurrentët, dokumente si studimi i marketingut, analizat e tregut të përgatitura për investitorët, plani i biznesit, vlerësime ekonometrike mbi elasticitetin.

### III.3. Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës.

- 26) Kur reagimi i firmave që duan të hyjnë është i shpejtë dhe i menjëhershëm, kemi të bëjmë me zëvendësueshmëri nga ana e ofertës ; ndërmarrjet që plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si konkurrentë ekzistues duhet të merren parasysh në përkufizimin e tregut përkatës së produkteve.
- 27) Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës mundet gjithashtu të merret parasysh kur përcaktohen tregjet, në ato situata ku efektet e tij janë ekuivalente me ato të zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës në terma të efektivitetit dhe të shpejtësisë së reagimit. Kjo nënkupton që ofruesit janë të aftë të këmbëjnë produktet e tyre me produktet e tregut përkatës dhe të tregtojnë ato në periudha afatshkurtra pa sjellë kosto të ndjeshme shtesë ose risk, në përgjigje të ndryshimeve të vogla dhe të përhershme në çmime relative. Kur arrihen këto kushte, produkti shtesë që është vënë në treg do të ketë një efekt të disiplinuar mbi sjelljen konkurruese të ndërmarrjeve të përfshira. Një ndikim të tillë në terma të efektivitetit dhe të shpejtësisë së reagimit, është ekuivalent me efektin e zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës.
- 28) Këto situata hasen veçanërisht kur ndërmarrjet tregtojnë një game të gjerë cilësie ose kategorie për të njëjtin produkt. Edhe n.q.s. për një konsumator përfundimtar ose grup konsumatorësh, cilësi të ndryshme do të grupohen në një produkt tregu, duke siguruar që shumica e ofruesve janë të aftë të ofrojnë dhe të shesin këto mallra me cilësi të ndryshme në mënyrë të menjëhershme dhe pa rritje thelbësore të kostove të përshkruara më sipër. Në këto raste, produkti përkatës i tregut do të përfshijë të gjitha produktet që janë të zëvendësueshme, sipas kërkesës dhe ofertës, si dhe shitjet aktuale të këtyre produkteve do të grumbullohen me qëllim që të llogaritet vlera totale ose volumi total i tregut. I njëjti arsyetim mund të çojë në grupimin e zonave të ndryshme gjeografike.
- 29) Një shembull praktik për analizën e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës kur përcaktohet tregu i produktit konstatohet në rastin e letrës. Letra zakonisht ofrohet në kategori të ndryshme cilësie, nga letra e shkruar standarde, te letra e cilësisë së lartë që do të përdoret, p.sh. për publikimin e librave të artit. Nga një këndvështrim i kërkesës, nuk mund të mos përfillen këto dallime cilësie në atë të letrës, pasi nuk mund të shtypet një libër arti ose një vepër letrare luksi duke përdorur një letër me cilësi të zakonshme. Megjithatë fabrikat e letrës mund të prodhojnë letër me cilësi të ndryshme dhe në afate të shkurtra mund ta përshtatin prodhimin duke mesatarizuar shumë pak kostot e papërfillshme të përshtatjes. Kur nuk ka vështirësi të veçanta në shpërndarje, prodhuesit e letrës janë të aftë të konkurrojnë për porosi të cilësive

të ndryshme, në veçanti n.q.s. porosinë janë shoqëruar me kohë të mjaftueshme që lejon modifikimin e planeve të produktit. Në këto rrethana Autoriteti nuk do të përcaktonte një treg të ndarë për secilën cilësi letre dhe përdorimin e saj përkatës. Cilësitë e ndryshme të letrës janë përfshirë në tregun përkatës dhe shitjet e tyre janë mbledhur me synim për të vlerësuar volumin dhe vlerën e tregut .

- 30) Kur zëvendësueshmëria nga ana e ofertës kërkon përshtatje të konsiderueshme të asetëve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, investimet shtesë, vendime strategjike ose vonesa në kohë, nuk merret në konsideratë në fazën e përkufizimit të tregut. Raste ku zëvendësueshmëria nga ana e ofertës në të cilat nuk zgjerohet përkufizimi i tregut, është rasti i produkteve për konsumatorët, p.sh. për pijet freskuese të markave. Në parim, megjithëse fabrikat që mbushin shishet mundet të mbushin me lloje të ndryshme pijesh, mallrat nuk mund të shiten në realitet veçse me çmim të përbërë nga kostot dhe vonesa kohore të rëndësishme (përpjekje të reklamimit, testimi të mallrave dhe shpërndarjen e tyre). Në këto raste, efektet e zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës dhe forma të tjera të konkurrencës potenciale do të shqyrtohen në një fazë të mëvonshme.
- 31) Informacioni që është i vlefshëm gjatë analizës së zëvendësimit nga ana e ofertës është: karakteristikat e produktit, informacion mbi variacionet e çmimeve dhe të shitjeve sipas zonës, sa ju kushton klientëve për të kërkuar produktet që furnizohen nga zona të tjera gjeografike etj

#### III.4 Konkurrenca potenciale

- 32) Burimi i tretë i kufizimit nga këndvështrimi i konkurrencës, konkurrenca potenciale, nuk merret në konsideratë kur përcaktohet tregu, deri kur kushtet nën të cilat ajo efektivisht mundet të sjellë një kufizim konkurrence, në varesi të analizës së një sërë faktorësh dhe rrethanash duke i krahasuar me kushtet e hyrjes. N.q.s kërkohej, kjo analizë ndërmerret vetëm në një fazë të dytë vijuese, përgjithësisht sapo pozicioni i ndërmarrjeve të përfshira në tregun përkatës të jetë siguruar tashmë, dhe kur kjo pozitë ngre shqetësimet nga një këndvështrim i konkurrencës.
- 33) Kur reagimi është i mundshëm por jo i menjëhershëm, kemi të bëjmë me konkurrencën potenciale; ndërmarrjet konsiderohen si konkurrentë potenciale, por nuk futen në tregun përkatës.

### IV. Procesi i përcaktimit të tregut përkatës në praktikë.

#### IV.1. Dimensioni i produktit .

- 34) Ka një sërë të dhënash që lejojnë vlerësimin e shkallës së zëvendësueshmërisë. Në rastet individuale, lloje të ndryshme të dhënash do të jenë përcaktuese në vartësi të karakteristikave dhe specifikave të industrive dhe produkteve që shqyrtohen. Të njëjtat lloje të dhënash nuk kanë të njëjtën rëndësi në raste të tjera. Në shumicën e rasteve, një vendim duhet të bazohet duke marrë në konsideratë një numër kriteresh dhe të dhënash. Autoriteti është transparent për metodat që ndjek mbi bazën e të dhënave empirike me qëllim që të arrijë në një përdorim eficient të të gjithë informacionit të nevojshëm që i përket rasteve individuale. Ai nuk ndjek një hierarki të ngurtë të informacionit ose tipeve të ndryshme të të dhënave.

- 35) Procesi i përkufizimit të tregut përkatës mund të përmbledhet si vijon: “Në bazë të një informacioni paraprak ose informacioni të ofruar nga ndërmarrjet e përfshira, Autoriteti do të ketë mundësi që të përcaktojë tregjet e mundshme përkatëse në kuadër të të cilëve p.sh një përqendrim ose një praktikë kufizuese e konkurrencës duhet të vlerësohet”. Në përgjithësi dhe për të gjitha qëllimet praktike kur trajtohen raste individuale, çështja do të ishte për të vendosur për disa alternativa të mundshme të tregut përkatës, Për sa i përket tregut të produktit, çështja shtrohet: n.q.s produktet A dhe B i përkasin ose jo të njëjtit treg të produktit qe shpesh. N.q.s në një përcaktim alternativ të besueshëm të tregut, veprimi në fjalë nuk ngre probleme të konkurrencës, çështja e përcaktimit të tregut do të lihet e hapur, duke ulur ngarkesën e ndërmarrjeve për ofrimin e informacionit.

#### IV.2. Dimensioni Gjeografik

- 36) Për të përcaktuar tregun gjeografik nevojitet një këndvështrim paraprak mbi bazën e një tërësie treguesish për sa i përket shpërndarjes së pjesës së tregut të palëve dhe konkurrentëve të tyre, po ashtu dhe një analizë paraprake e procesit të vendosjes së çmimit dhe të diferencave në çmime në nivel lokal dhe atë kombëtar. Ky këndvështrim paraprak përdoret kryesisht si një hipotezë për të fokusuar kërkimet e Autoritetit me qëllim që të arrihet në një përkufizim sa më të saktë të tregut gjeografik.
- 37) Arsytet që qëndrojnë pas çdo konfigurimi të veçantë të çmimeve dhe pjesëve të tregut duhet të studiohen. Ndërmarrjet mund të zotërojnë pjesë të mëdha të tregut të brendshëm për arsye të peshës në të kaluarën dhe anasjelltas. Hipotezat e para drejtohen kundrejt një analize të karakteristikave të kërkesës (rëndësia e preferencave kombëtare ose lokale, modelet aktuale të blerjes nga konsumatorët, diferencimet në produkt/marka, etj.) me qëllim që të dallohet nëse shoqëritë në zona të ndryshme realisht krijojnë një burim alternativ të ofertës për konsumatorët. Eksperimenti teorik është përsëri i bazuar mbi zëvendësueshmërinë si pasojë e ndryshimeve në çmimet relative, dhe pyetja për tu përgjigjur është gjithashtu: nëse klientët e palëve do të zhvendosnin porositë e tyre drejt ndërmarrjeve të vendosura diku tjetër në një periudhë afatshkurtër dhe me një kosto të pa konsiderueshme.
- 38) N.q.s. është e nevojshme, do duhet të ndërmerret një kontroll i mëtejshëm mbi faktorët e ofertës për t’u siguruar që ato ndërmarrje të cilat janë vendosur në zona të ndryshme, nuk përballen me pengesa për shitjet e tyre në terma të konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun gjeografik si një të tërë. Kjo analizë do të përfshijë një shqyrtim të kërkesave për një prani lokale me qëllim: të shitjes në këtë zonë, kushtet e hyrjes në kanalet e shpërndarjes, kostot e shoqëruara me ngritjen e një rrjeti shpërndarjeje, dhe prezenca ose mungesa e pengesave rregullatorë që ngrihen si pasojë e prokurimit publik, rregullimi i çmimeve, kuotave dhe tarifave që limitojnë tregtinë ose prodhimin, standardet teknike, monopolet, liria e krijimit të një biznesi, kërkesat për autorizim administrativ, rregullimin e paketimeve, e.t.j.
- 39) Shkurtimisht, Autoriteti duhet të identifikojë pengesat e mundshme që izolojnë ndërmarrjet e ndodhura në një zonë të dhënë, nga presioni konkurrues i ndërmarrjeve të ndodhura jashtë kësaj zonë, me qëllim që të përcaktohet shkalla e saktë e penetrimit të tregut në nivel kombëtar dhe më gjerë.

- 40) Modelet aktuale dhe evoluimi i tregtisë sjellin tregues të nevojshëm shtesë duke krijuar tregje të ndryshme gjeografike, si për rëndësinë ekonomike të secilit nga faktorët e kërkesës ose ofertës të përmendur më sipër, ashtu dhe për shtrirjen tek e cila ato mund ose nuk mund të ndërtojnë pengesa aktuale. Analiza e tregjeve të zhvilluara në përgjithësi ngre pyetjen e kostove të transportit dhe shtrirjen në të cilën ato mund të vështirësojnë tregtinë ndërmjet zonave të ndryshme, duke pasur parasysh vendndodhjen e fabrikave, koston e produktit dhe nivelet e çmimeve relative.

#### IV. 3 Procesi i mbledhjes së të dhënave

- 41) Kur nevojitet të bëhet përcaktimi i saktë i tregut, Autoriteti duhet të kontaktojë shpesh me klientët kryesorë dhe ndërmarrjet kryesore në industrinë e linjës për tu informuar mbi këndvështrimin e tyre për kufijtë e tregut të produktit dhe atij gjeografik dhe të marrë të dhëna faktike të nevojshme për të arritur në një përfundim të caktuar. Autoriteti, mundet gjithashtu të kontaktojë shoqatat përkatëse profesionale të biznesit dhe ndërmarrjet aktive në tregjet e shumicës, me qëllim që të jetë në gjendje të përcaktojë, kur është e nevojshme tregjet e produktit dhe ato gjeografikë, të ndara për nivele të ndryshme të produktit ose shpërndarjes së produkteve në fjalë. Gjithashtu mund të kërkojë informacion shtesë për ndërmarrjet e përfshira.
- 42) Nëse është e nevojshme, Autoriteti i kërkon aktorëve të tregut të përmendur më lart, informacion mbi tregun përkatës. Këto kërkesa përfshijnë zakonisht pyetje që lidhen me perceptimet e ndërmarrjeve ndaj reagimeve të rritjes hipotetike të çmimeve dhe këndvështrimeve të tyre për kufijtë në tregun përkatës.
- 43) Autoriteti, do të kërkojë informacion faktik që konsiderohet i nevojshëm për të arritur në konkluzione për shtrirjen e tregut përkatës. Ai mundet gjithashtu të diskutojë me zyrtarë të këtyre ndërmarrjeve, për të arritur një kuptim më të drejtë për mënyrën se si zhvillohen negociatat midis ofruesve dhe klientëve si dhe të çështjeve që lidhen me tregun përkatës. Kur është e nevojshme, Autoriteti mundet gjithashtu të shkojë në ambientet e palëve, të klientëve të tyre dhe/ose të konkurrentëve të tyre, me qëllim që të sqarohen proceset e produktit dhe të shitjes së produkteve.

#### IV.4. Të dhëna për përcaktimin e tregjeve-dimensioni i produktit

- 44) Llojet e të dhënave që Autoriteti i konsideron përkatëse për të vlerësuar nëse dy produkte janë të zëvendësueshme nga ana e kërkesës, mund të klasifikohen si më poshtë:
- a- Të dhënat e një zëvendësimi në një të shkuar të afërme. Në raste të caktuara është e mundur që të analizohen të dhëna që lidhen me situata të kohëve të fundit ose tronditjeve në treg që ofrojnë shembuj aktualë të zëvendësueshmërisë midis dy produkteve. Kur ka pasur ndryshime në çmimet relative në të kaluarën (duke i konsideruar faktorët e tjerë të pandryshueshme), reagimi në termat e sasisë të kërkuara, do të jenë vendimtare për të vërtetuar zëvendësueshmërinë. Hedhja në treg e produkteve të reja në të kaluarën, mund të ofrojë informacion të nevojshëm kur është e mundur, që në mënyrë të saktë të analizohen produktet të cilat kanë humbur shitje si pasojë e produkteve të reja.



- b- Pikëpamjet e klientëve dhe të konkurrentëve. Autoriteti në kuadër të monitorimit, kontakton me klientët dhe konkurrentët kryesorë të ndërmarrjeve përkatëse, me qëllim njohjen e pikëpamjeve të tyre mbi kufijtë e tregut të produktit, ashtu si dhe informacionet më të nevojshme për të arritur në konkluzionin e përcaktimit të tregut. Përgjigjet e arsyetuara të klientëve dhe konkurrentëve, për atë se çfarë do të ndodhte nëse çmimet relative të produkteve të konsideruara si të zëvendësueshme rriten lehtë (për shembull nga 5 në 10% ) në territorin gjeografik potencial, merren parasysh kur janë të mbështetura në të dhëna faktike.
- c- Preferencat e konsumatorëve. Në rastin e mallrave të konsumit, mund të jetë e vështirë për Autoritetin që të njohë direkt pikëpamjen e konsumatorëve përfundimtar, mbi produktet zëvendësuese. Studimet e tregut të përdorura në të kaluarën nga ndërmarrjet për vendimmarrjen e tyre lidhur me fiksimin e çmimeve të produkteve të tyre dhe/ose përcaktimin e veprimeve të tyre tregtare të marketingut, mund t'i sigurojnë Autoritetit të dhëna të vlefshme për të përkufizuar tregun përkatës. Anketimet e konsumatorëve për të njohur zakonet e tyre të konsumit dhe të sjelljeve të blerjeve, mendimet e shprehura nga shitësit me pakicë dhe në mënyrë më të përgjithshme, studimet e tregut të dërguara nga palët dhe nga konkurrentët e tyre, gjithashtu duke marrë parasysh edhe rëndësinë e markave për produktet në fjalë, janë përdorur për të përcaktuar nëse një pjesë domethënëse e konsumatorëve i konsiderojnë dy produkte si të zëvendësueshëm.

#### IV.5. Kostot e transferimit të kërkesës kundrejt produkteve potencialisht të zëvendësueshme.

Ekzistojnë një numër pengesash dhe kostosh që mund ta prapësojë Autoritetin që të konsiderojë dy produkte zëvendësuese nga ana e kërkesës të të njëjtit treg përkatës. Është e pamundur të hartohet një listë e plotë e të gjitha pengesave potenciale për zëvendësim të produktit ashtu si dhe të kostove të transferimit. Këto pengesa mund të kenë gamë të gjerë origjinash.

Kategori të ndryshme të konsumatorëve dhe diskriminimi i çmimit. Një grup klientësh, të një produkti përkatës mund të krijojnë një treg të veçantë, më të ngushtë kur mund të jetë subjekt i diskriminimit të çmimit. Në këto raste duhet të plotësohen dy kushte:

- a. të përcaktohet se cilit grup i përket një klient individual në momentin që produkti përkatës i shitet atij; dhe
- b. kur tregtia midis klientëve ose arbitrazhi nga palët e treta nuk mund të realizohen.

#### IV.6. Të dhënat për të përcaktuar tregjet – Dimensionin gjeografik.

45) Llojet e të dhënave që Autoriteti merr në konsideratë për të arritur në një konkluzion mbi përcaktimin e tregut gjeografik janë si vijon:

- a. Prova që në të shkuarën ka pasur zhvendosje të porosive drejt zonave të tjera gjeografike. Në raste të caktuara, të dhënat mbi ndryshimin e çmimeve midis zonave të ndryshme dhe reagimet e mundshme të klientëve mund të jenë të nevojshme. Në përgjithësi, të njëjtat teste cilësore të përdorura për të përcaktuar tregun e produkteve, mund të shërbejnë në përcaktimin e tregut gjeografik, por duhet të kemi parasysh se krahasimet e çmimit në shkallë ndërkombëtare mund të jenë më komplekse, si rezultat i disa faktorëve si: luhatjet e kursit të këmbimit, taksat dhe diferencat cilësore të produkteve.

- b. Karakteristikat themelore të kërkesës. Natyra e kërkesës për produktin përkatës mund të përcaktojë shtrirjen e tregut gjeografik. Faktorë të tillë si preferencat kombëtare ose preferencat për marka kombëtare, gjuha, kultura, stili i jetesës dhe nevoja e një prezence lokale, kanë mundësi të konsiderueshme për të kufizuar shtrirjen gjeografike të konkurrencës.
  - c. Pikëpamjet e klientëve dhe konkurrentëve. Kur është e përshtatshme, Autoritetit kontakton klientët dhe konkurrentët e palëve gjatë monitorimit të tregut me qëllim marrjen e mendimeve të tyre mbi kufijtë e tregut gjeografik, ashtu si dhe pjesën më të madhe të fakteve.
  - d. Shpërndarja gjeografike e blerjeve. Një shqyrtim i shpërndarjes aktuale gjeografike të blerjeve siguron të dhëna të nevojshme mbi shtrirjen e mundur të tregut gjeografik.
  - e. Flukset tregtare dhe të transportit. Kur numri i klientëve është shumë i madh dhe nuk është e mundur krijimi i një imazhi të qartë të shpërndarjes gjeografike të blerjeve vetëm mbi bazën e informacioneve të marra nga ata, informacioni alternativ mbi flukset tregtare mund të përdoret duke u mbështetur në statistikat tregtare për produktin përkatës. Flukset tregtare dhe analiza e tyre, lejon marrjen e informacioneve për të përcaktuar tregun gjeografik, por ato nuk përbëjnë në vetvete konkluzione përfundimtare.
  - f. Pengesat dhe kostot e transferimit që çojnë në riorientimin e porosive drejt ndërmarrjeve në zona të tjera. Mungesa e blerjeve ose e flukseve tregtare ndërkufitare, për shembull, nuk do të thotë domosdoshmërisht që tregu të jetë vetëm kombëtar. Para se të arrijmë në përfundimin që një treg gjeografik përkatës është kombëtar, duhet të shikojmë nëse nuk ekzistojnë pengesa që e izolojnë atë. Pengesa më e qartë për një konsumator që ti zhvendosë porositë e tij në një zonë tjetër gjeografike, është impakti i kostos së transportit, kufizimet e transportit që vijnë nga legjislacioni ose natyra e produkteve përkatëse. Impakti i kostove të transportit zakonisht kufizon shtrirjen e një tregu gjeografik për produktet voluminoze me vlera të vogla; duke pasur parasysh që disavantazhet e transportit mundet gjithashtu të kompensohen nga një avantazh krahasues në kostot të tjera (kosto e punës ose lëndët e para). Aksesit në rrjetet e shpërndarjes në një zonë të dhënë, pengesat rregullatore që ekzistojnë në sektorë të caktuar, kuotat ose tarifatat doganore, gjithashtu mund të krijojnë pengesa që izolojnë një zonë gjeografike të dhënë nga presioni konkurrencial i ndërmarrjeve jashtë kësaj zone.
- 46) Mbi bazën e të dhënave të mbledhura, Autoriteti përcakton një treg gjeografik që mund të shkojë nga një dimension lokal në një dimension global.
- 47) Pikat e mëposhtme përshkruajnë faktorët e ndryshëm që mund të shërbejnë për të përcaktuar tregjet përkatëse. Kjo nuk do të thotë që në çdo rast individual do të jetë i nevojshëm mbajtja e të dhënave dhe vlerësimi i secilit faktor. Shpesh në praktikë të dhënat merren nga një bashkim apo grupim i këtyre faktorëve që janë të mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion.

## V. LLOGARITJA E PJESËVE TË TREGUT

- 48) Përcaktimi i tregut përkatës si në dimensionin e produktit dhe atë gjeografik, lejon të identifikohen se cilët janë aktorët (ofruesit, klientët/ konsumatorët) aktivë në këtë

treg. Mbi këtë bazë, është e mundur llogaritja e madhësisë totale të tregut si dhe e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve, mbi bazën e shitjeve të tyre në tregun e produktit përkatës në zonat përkatëse. Në praktikë, madhësia totale e tregut dhe pjesët e tregut të ndërmarrjeve, shpesh janë të disponueshme nga burimet e tregut, p.sh vlerësimet e ndërmarrjeve, studimet e kërkuara nga industritë përkatëse dhe/ose nga shoqatat e biznesit. Në raste të tjera, kur këto vlerësime nuk janë të besueshme, Autoriteti i kërkon secilit ofrues në tregun përkatës që t'i sigurojë shifrat e tij të shitjes, në mënyrë që të mund të llogarisë madhësinë totale të tregut dhe pjesët e tregut të secilit.

- 49) Shitjet janë përgjithësisht referenca për të llogaritur pjesët e tregut. Megjithatë ka tregues të tjerë, që varen nga produkte specifike ose industri të veçanta, që mund të ofrojnë informacion të vlefshëm, si p.sh. kapaciteti, numri i operatorëve në tregjet e produkteve të prokuruar, njësitë e flotave në rastin ajro-hapësinor ose rezervat e mbajtura në rastin e sektorëve si ato të shfrytëzimit të minierave.
- 50) Si rregull, si volumet ashtu dhe vlerat e shitjes përbëjnë një informacion të nevojshëm. Në rastet e produkteve të diferencuara, duhet të merren në konsideratë shitjet në vlerë e shoqeruar dhe me pjesët e tregut të secilit, për një reflektim më e mirë të pozicionit relativ dhe të fuqisë së çdo ofruesi. Një firmë që ka pjesë të madhe në treg mund të ketë mundësinë të rrisë çmimet e saj në mënyrë të pavarur nga firmat e tjera. Ndryshimet e pjesëve të tregut në kohë mund të na japin të dhëna mbi dinamikën e tregut.
- 51) Autoriteti i Konkurrencës do të përcaktojë tregun përkatës rast pas rasti sipas çështjes në shqyrtim.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 77 Datë 11.04.2008**

**“Për  
Disa Rekomandime për Tregun e Telekomunikacioneve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.04.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Rekomandime ndaj institucioneve publike në lidhje me çështjet e ndërprerjes së marrëveshjes së interkoneksionit dhe liberalizimit të trafikut ndërkombëtar të telefonisë.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa f dhe neni 70, pika 2.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit të Monitorimit “Mbi çështjet e ndërprerjes së marrëveshjes së interkoneksionit dhe liberalizimit të trafikut ndërkombëtar të telefonisë” të hartuar nga Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregjeve.

**V Ë R E N S E:**

**I. Fusha e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës**

1. Ligji nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (këtu e në vijim “Ligji”) zbatohet për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg dhe që e

ushtrajnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 2 i Ligjit). Albtelekom sh.a., Albanian Mobile Communication (AMC) sh.a., Vodafone sh.a. dhe 55 Operatorë Alternativë (Ruralë) ofrojnë shërbime të telekomunikacioneve në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe konsiderohen si “ndërmarrje”, në bazë të nenit 3 pika 1 të këtij ligji. Si rrjedhim, veprimtaria e këtyre ndërmarrjeve përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

## II. Çështja në shqyrtim

1. Monitorimi i sjelljes së mundshme abuzive të AMC sh.a, Vodafone, sh.a dhe Albtelekom sh.a me pozitën dominuese në treg.

## III. Përcaktimi i tregut përkatës

Tregu përkatës përfshin:

- Tregun me shumicë të produktit dhe brenda tregut të shumicës shqetësimet përfshijnë “shërbimet e tranzitimit në rrjetet publike të telefonisë fikse” dhe tregut të shërbimit të interkoneksionit në përputhje me rekomandimet e Komisionit Europian.
- dhe Tregun gjeografik është gjithë territori i Republikës së Shqipërisë.

## IV. Pikëpamjet kryesore

Viti 2007 ishte viti i ndryshimeve të mëdha në tregun e telekomunikacioneve në Shqipëri. Më 1 tetor 2007 përfundoi procedura e privatizimit përfundimtar të 76 % të aksioneve të Albtelekom, operatorit të vetëm kombëtar në tregun e telefonisë fikse, dhe menaxhimi i kompanisë kaloi në duar të Çalik Energjie a.s. Po ashtu, pjesë e kontratës së shitjes së Albtelekom ishte edhe pjesa e 76 % të aksioneve të operatorit të tretë të telefonisë së lëvizshme, “Eagle Mobile” sh.a.

Rishikimi nga ana e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve të licencave të të ashtuquajturve “operatorë ruralë”, duke iu dhënë atyre mundësinë e ofrimit të shërbimit edhe në zonat urbane, me emërtimin e ri “operatorë alternativë”, përbën një tjetër zhvillim të rëndësishëm të Sektorit të Telekomunikacioneve.

Këto ndryshime rrënjësore në sektorin e telekomunikacioneve kanë sjellë një ridimensionim thelbësor të marrëdhënieve kontraktuale dhe faktike ndërmjet operatorëve që veprojnë në këtë sektor, ridimensionim që është shoqëruar edhe me probleme dhe ankesa të ndërsjella ndërmjet këtyre operatorëve.

Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar pretendimet e Operatorëve Alternativë të cilët veprojnë në tregun e telekomunikacionit, me anë të të cilëve këta operatorë ankohen në ERT për veprime abuzive nga ana e Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT). Po ashtu vetë operatorët e shpallur OFNT, pretendojnë se operatorët alternativë janë duke kryer veprimtari të jashtëligjshme dhe që nuk parashikohet në marrëveshjet ekzistuese të interkoneksionit.

Operatorët alternativë pretendojnë se OFNT-të janë duke abuzuar me pozicionin e tyre dominues në treg duke synuar eliminimin e konkurrencës nëpërmjet ndërprerjes së

njëanshme ose mos lidhjes së Marrëveshjeve të Interkoneksionit, duke shkelur germën (dh), pika 2, të nenit 9 të “Ligjit”.

Për këtë arsye, Autoriteti i Konkurrencës e pa të arsyeshme dhe të domosdoshme vlerësimin e këtyre ankesave, për të parë nëse këto OFNT realisht po abuzojnë me pozitën e tyre në treg, duke shtrembëruar ose kufizuar konkurrencën, në kundërshtim me dispozitat e nenit 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

## **V. Periudha e Monitorimit**

Monitorimi i sjelljes së Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg kundrejt Operatorëve Alternativë përfshinte periudhën tetor 2007-31 mars 2008.

## **VI. Procedurat e ndjekura**

Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar me vëmendje zhvillimet në tregun e telekomunikacioneve për shkak të zhvillimeve të reja, ndryshimeve në strukturën e tregut, evoluimit të teknologjisë dhe konkurrencës së pamjaftueshme që ekziston në këtë treg.

Shumë nga shkresat e dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës përmbanin element shumë specifik të rregullimit të Sektorit të Telekomunikacioneve, duke përbërë kryesisht detyrime të ndërhyrjes së Rregullatorit në përputhje me ligjin ekzistues “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe për këtë arsye është kërkuar bashkëpunimi i ngushtë me Entin Rregullator të Telekomunikacioneve. ERT ka nxjerrë tre vendime lidhur me këto çështje të cilat janë marrë në konsideratë gjatë procesit të monitorimit.

Ndërkohë Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur procedurat monitoruese dhe sqaruese me të gjitha palët për çështjet që lidheshin ngushtësisht dhe ekskluzivisht me ligjin 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Për këtë arsye gjatë periudhës së monitorimit janë shkëmbyer një sërë shkresash me ndërmarrjet dhe janë zhvilluar disa seanca dëgjimore të organizuara nga Sekretariati me operatorët me fuqi të ndjeshme në treg, Altelecom sh.a, AMC sh.a dhe Vodafone sh.a dhe disa prej operatorëve alternativë.

## **VII. Problemet e kufizimit të konkurrencës që janë shfaqur në treg.**

- 1) Tranzitimi i thirrjeve ndërkombëtare, të modifikuara si kombëtare, drejt abonentëve të Altelekom, nga ana e operatorëve alternativë.

Problemi i tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare është pasojë kryesisht e mungesës së bazës ligjore. ERT duhet të plotësojë nga ana e tij kuadrin e nevojshëm ligjor i cili do të përcaktonte licencat, kushtet, mënyrën dhe procedurat për të ofruar këtë shërbim për hapjen e këtij tregu (tregu i tranzitimit të thirrjeve ndërkombëtare).

Në bazë të VKM-së Nr. 464, datë 03.07.2003, shërbimet telefonike ndërkombëtare do të hapen për konkurrencë në vitin 2005. Kjo VKM është miratuar për të përmbushur angazhimet e qeverisë shqiptare në kuadër të integritimit në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT).

Në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare Shqipëria duhej të hapte këtë treg për konkurrencë në fund të vitit 2003, por pas negociatave me OBT-në është arritur që ky afat të shtyhet për një vit. VKM-ja Nr. 464, datë 03.07.2003, vetëm sa bënë këtë shtyrje dhe thotë që: -“në fund të vitit 2004 mbaron ekskluziviteti”, por nuk bënë të qartë se cilat shërbime do të hapen realisht për konkurrencë. Pra edhe pse është pranuar që tregu do të hapet për konkurrencë, në të vërtetë nuk është përcaktuar plotësisht në legjislacioni.

Duket qartë se pretendimet e tyre, OFNT-të i mbështesin tek mangësitë e kuadrit ligjor që duhet të rregullojë këto marrëdhënie. Në të vërtetë në licencat që kanë operatorët alternativë nuk është specifikuar ofrimi i një shërbimi të tillë dhe kjo gjë përdoret nga OFNT-të si arsye se këta operatorë nuk e kanë këtë të drejtë. Nga ana tjetër operatorët alternativë theksojnë se e njëjta gjë është e vërtetë edhe për OFNT-të, pasi edhe këto nuk e kanë të cituar në licencë ofrimin e këtij shërbimi.

Disa nga operatorët i kanë kërkuar ERT që të bëjë një interpretim se kush e ka të drejtën për të realizuar këtë shërbim. ERT me VKM nr. 431, datë 30.01.2008 është shprehur se: “të drejtën për ofrimin e shërbimit të tranzitimit të trafikut telefonik ndërkombëtar e ka vetëm Albtelekom dhe të gjithë operatorët e tjerë e kanë këtë të drejtë vetëm për pajtimtarët e tyre”.

Megjithatë Vendimi i ERT Nr. 444, datë 26.03.2008 ka shpallur absolutisht të pavlefshëm Vendimin e mëparshëm të ERT Nr. 431, datë 30.01.2008 dhe ka rinisur shqyrtimin e të gjitha ankesave që janë dërguar pranë ERT-së lidhur me tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare.

Tranzitimi i thirrjeve ndërkombëtare, përveç plotësimit të kuadrit ligjor, ka nevojë edhe për një qartësim tjetër, pasi në thelb ka konkurrencën ndërmjet dy teknologjive, atë të thirrjeve telefonike tradicionale nga njëra anë dhe teknologjinë e re VOIP. VOIP është një teknologji me kosto shumë të ulët, krahasuar me teknologjinë tradicionale, dhe avancimet në teknologjinë VOIP duket se po e bëjnë këtë shërbim një zëvendësues të thirrjeve tradicionale, kjo duket se është më e vërtetë për thirrjet ndërkombëtare. Megjithatë vlerësimi, nëse VOIP është një zëvendësues për telefoninë tradicionale kërkon një analizë të plotë nga ERT-ja, e cila i ka të gjitha kapacitetet teknike për ta bërë një gjë të tillë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit:

### **VENDOSI:**

1. Ti rekomandojë ERT-së, plotësimin e kuadrit nënligjor për tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare si dhe miratimin e licencave tip për të gjithë operatorët që veprojnë në tregun e komunikimeve elektronike dhe që ushtrojnë tranzitimin e thirrjeve telefonike ndërkombëtare duke pasur parasysh :
  - I. angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare si anëtare e OBT-së;
  - II. angazhimet në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit ;

- III. VKM Nr. 288, datë 18.6.1999 (i ndryshuar) “për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Ti rekomandojë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve të rregullojë dhe licencojë ofrimin e shërbimeve alternative si VOIP.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

( )  
Zv/Kryetar

( )  
Anëtar

( )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**KRYETARE**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 78 Datë 25.04.2008**

**Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të 65% të kapitalit në shoqërinë Alba Cement Italia sh p k nga shoqëria Antea Cement Sh A**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.04.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar me datë 1 shkurt 2008 nëpërmjet shitblerjes të 65% të aksioneve të shoqërisë Alba Cement Italia Shpk. te shoqëria Antea Cement Sh A. dhe të njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 06.02.2008.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të kapitalit 65% të shoqërisë Alba Cement Italia Shpk te shoqëria Antea Cement ShA;

## V Ë R E N S E:

Transaksioni që përfundoi me nënshkrimin e marrëveshjes së shitjes së aksioneve nga palët pjesëmarrëse, është kryer në datën 1 shkurt 2008<sup>1</sup> dhe u njoftua në Autoritetin e Konkurrencës në datën 6 shkurt 2008 në përputhje me afatin 1 javor të përcaktuar në nenin 12 pika 2 të ligjit. Marrëveshja parashikon mënyrën e transferimit të aksioneve, çmimin e blerjes dhe kushtet e tjera të domosdoshme për realizimin e transaksionit.

### I. PALËT NË TRANSAKSION:

- **Alba Cemento Italia sh.p.k.** është shoqëri italo shqiptare e themeluar në vitin 2000 sipas legjislacionit shqiptar mbi shoqëritë tregtare, e zotëruar nga 3 ortakë ku më i madhi zotëron 50% dhe dy të tjerët nga 25% të pjesës të kapitalit themeltar. Selia e saj është në komunën Kashar, Tiranë. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është importimi, ambalazhimi dhe tregtimi i çimentos së hirtë të tipit 32.5R dhe 42.5R, rifuxhio dhe e ambalazhuar në thasë 30-50 kg, të paketuara në paleta, si dhe produkteve të ndërtimit me bazë cimento.

Alba Cemento Italia sh.p.k. është **shitësi** i pjesës prej 65% të kapitalit, që përfshin shitjen e pjesës prej 50% të kapitalit të ortakut kryesor dhe respektivisht pjesët prej 7% dhe 8%, të kapitalit të dy ortakëve të tjerë.

Dy ortakët që pas përfundimit të transaksionit mbeten në minorancë, si persona fizikë, kanë pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në tregje të ndryshme nga tregu i importimit dhe tregtimit të çimentos, si në shoqëritë Alba elektrik shpk dhe Alba Termal shpk, me qendër në Tiranë, ku zotërojnë respektivisht çdonjeri pjesët prej 50% dhe 40% dhe ku ushtrojnë veprimtarinë e importit dhe tregtimit të materialeve elektrike, kondicionerë, paisje ngrohje ftohje dhe instalimeve të tyre.

- Për vitin 2006, xhiro në tregun brendshëm është 995 milion lekë
- Për vitin 2007<sup>2</sup>, xhiro në tregun e brendshëm është 953 milion lekë

- Shoqëria **Antea Cement sh.a.** është shoqëri e krijuar dhe organizuar në bazë të legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare, me seli në Tiranë, Shqipëri, me numër regjistrimi 36120 datë 07.07.2006, me objekt ndërtimin e një fabrike për prodhimin e çimentos me kapacitet 1.5 milion ton në vit<sup>3</sup>. Shoqëria Antea Cement sh.a. është pjesë e Titan Group, që drejtohet nga kompania mëmë Titan Cement Company S.A., me qendër në Greqi. Prioritetet e Titan Group janë: a) zgjerimi i veprimtarisë kryesore të biznesit të çimentos nëpërmjet blerjeve; b) Integrimi vertikal lidhur me materialet e ndërtimit; ç) Përmirësimi i vazhdueshëm i efektivitetit të kostos dhe konkurrueshmërisë etj. Titan Group përbëhet nga më shumë se 40 shoqëri, të shtrira në 4 zona gjeografike: Greqi dhe Europën Perendimore, SHBA dhe Kanada, Europën Juglindore dhe Lindjen e Mesme, duke mbuluar gjithë spektrin e materialeve të ndërtimit, që nga agregatet e deri te llojet e ndryshme të cimentos së hirtë, cimentos së bardhë etj. Aktualisht, kompania mëmë e Titan Group ka prezencë tregtare të drejtëpërdrejtë në tregun shqiptar të çimentos,

<sup>1</sup> Sipas kopjes së noterizuar të marrëveshjes së shit-blerjes së aksioneve

<sup>2</sup> Bilanci i vitit 2007 është i pakonsoliduar

<sup>3</sup> Miratuar me Ligjin Nr 9813, datë 1.10.2007. Fletorja zyrtare Nr 137, datë 19 tetor 2007, fq 3787.

nëpërmjet degës të shoqërisë bijë Albacem<sup>4</sup> dhe indirekt nëpërmjet shoqërisë Aemos Ltd. dhe Alvacim Ltd., tek Antea Cement sha.

Antea Cement sha. është **blerësi** i pjesës prej 65% të kapitalit të shoqërisë Alba Cemento Italia sh.p.k.

Antea Cement sha. në tregun e brendshëm nuk kontrollon me anë të pronësisë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë asnjë shoqëri aktive në tregun e prodhimit/importimit apo tregtimit të çimentos.

Për vitin 2006, xhiro totale e Titan Group është 195, 615 milion lekë e ndarë në:

- a) **tregun ndërkombëtar** është 195 miliard lekë; dhe
- b) **tregun e brendshëm** është 615 milion lekë<sup>5</sup>.

Për vitin 2007, xhiro totale e Titan Group është 184, 677 milion lekë e ndarë në:

- a) **tregun ndërkombëtar** është 184 miliard lekë; dhe
- b) **tregun e brendshëm** është 677 milion lekë

- Ky transaksion, që përbën përftimin e kontrollit të një pjesë të kapitalit dhe të së drejtës së votës, është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b) dhe nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

## II. VLERËSIMI I KONKURRENCËS

### II.1 Tregu Përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

- 1) Tregu i produktit është tregu i çimentos<sup>6</sup>, që përsa i takon karakteristikave (vetive fizike), qëllimit të përdorimit, transportimit dhe tregtimit, ndahet në disa grupe, si:
  - a) Çimento e hirtë;
  - b) Çimento e bardhë
  - c) Materiale ndërtimi me bazë çimento (kolla, ngjitësit e ndryshëm etj).

Secili nga këto produkte përbën një nëntreg produkti. Çimento e hirtë zë peshën specifike më të lartë ndaj totalit të importit<sup>7</sup> respektivisht për vitin 2006 dhe 2007 është 66% dhe 56%.

<sup>4</sup> Albacem Cement S.A. është regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Tiranë. Albacem është përfaqësuesja e markës Titan në Shqipëri.

<sup>5</sup> Bilanci i Titan Cement S.A. dhe filialeve të tij Titan Group, përfaqësuar në Shqipëri nga Alba Cement

<sup>6</sup> Transaksioni që synon në realizimin e një përqendrimi, ndodh në tregun e importimit dhe tregtimit të produktit çimento

<sup>7</sup> Burimi: Drejtoria e Përgjithshme Doganave

II.1.a Tregu i produktit për Alba Çimento Italia ShPK. përfshin importimin dhe tregtimin e produktit çimento të markës tregtare Buzzi Unicem, rifuxhio dhe të ambalazhuar në thasë letre 50 kg, të paketuara në paleta 1.95 ton, si dhe produkteve të ndërtimit me bazë çimento.

Pjesa e tregut të shoqërisë Alba Çimento Italia shpk. ndaj totalit të tregut të brendshëm të produktit (importim dhe tregtim çimento) është rreth 5%.

II.2.a Tregu i produktit para përqendrimit për shoqërinë Antea Cement ShA. përfshin:

- (i) Studime teknike, projektim dhe punime përgatitore (shpimet gjeologjike dhe gjeoteknike, rrugët e hyrjes);
- (ii) Shfrytëzimin e karierave;
- (iii) ngritjen e fabrikës së prodhimit të çimentos së hirtë.
- (iv) Tregtimi i produkteve të çimentos

Shoqëria Antea Cement ShA Për vitin 2007 nuk ka veprimtari importimi apo tregtimi të produktit çimento.

II.3.b. Tregu gjeografik:

- Shoqëria Alba Cement Italia shpk. ushtron veprimtari në një treg të kufizuar (në Tiranë Durrës Krujë) brenda tregut të brendshëm.
- Shoqëria Antea Cement ShA ushtron veprimtari në një treg të kufizuar (në Borizanë-Krujë) brenda tregut të brendshëm.

Palët pjesëmarrëse veprojnë në të njëjtin treg produkti të ndryshme dhe në nuk kanë klientë të përbashkët. Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura sipas seksionit 6 (III) të “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, nuk ka tregje të prekura nga përqendrimi i njoftuar.

### III. Struktura e tregut, Pjesët e tregut dhe Konkurrentët në tregun e brendshëm.

1. Tregu i prodhimit/importimit dhe tregtimit të çimentos në Shqipëri është një treg në zhvillim, që me përfundimin e dy fabrikave të reja në vitin 2010 do plotësojë jo vetëm kërkesat e vendit, por pritet edhe të eksportojë.
2. Prodhimi në vend realizohet në fabrikat e çimentos në Fushë-Krujë dhe Elbasan si dhe përfaqësohet në treg me markën tregtare Seament, që për vitin 2007 zinte 45.4% të pjesës së tregut të produktit.
3. Pjesa e tregut të importit sipas markave tregtare (originës së importit) në total zë 54.6% dhe ndahet ndërmjet 5 importuesve, nga të cilët më i madhi zotëron 17.5% dhe më i vogli 2% dhe importues të tjerë të vegjël që në total zënë rreth 1% të tregut.
4. Tregu i çimentos është një treg shumë i përqendruar si para edhe pas përqendrimit, për shkak të pozicionit dominues të prodhuesit të markës Seament. Indeksi i përqendrimit HHI është respektivisht 2806 dhe 2931.
5. Transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit nëpërmjet blerjes të paketës prej 65 % të aksioneve nga Antea Cement sha. brenda shoqërisë A.C.I shpk, duke ndikuar në politikën e kësaj shoqërie, në radhë të parë për sa i përket ndryshimit të burimit të importimit të markës Buzzi/Unicem (Itali) dhe zëvendësimin e saj me markën tregtare Titan, me origjinë nga Greqia.

6. Hyrja e shoqërisë Antea Cement sha, nëpërmjet përfimit të kontrollit mbi një pjesë të rëndësishme në shoqërinë A.C.I shpk krijon mundësi për facilitete depozitimi në rajonin e Tiranës, për produktin e çimentos të Titan Group. Gjithashtu, marrja përsipër e të gjithë veprimtarisë ekonomike të degës Alba Cement nga shoqëria Antea Cement sha, rrit pjesën e kombinuar të tregut për çimenton e markës tregtare Titan në total në masën 17.5%.

Në këtë kontekst, ky përqendrim nuk shkakton efekte anti-konkurrese, dhe në kuptim të nenit 13, pika 1 e Ligjit, nuk krijon pozitë dominuese të ndërmarrjeve të përfshira në përqendrim, pra, nuk ka lidhje shkakësore midis realizimit të këtij përqendrimi dhe krijimit të pozitës dominuese.

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës:

### VENDOSI:

1. Të autorizojë, përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes të 65% të kapitalit të shoqërisë Alba Cement Italia shpk, me qendër në Shqipëri, nga shoqëria Antea Cement ShA, me qendër në Tiranë, Shqipëri.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për publikimin e autorizimit dhe njoftimin e palëve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(                    )  
Zv/Kryetar

(                    )  
Anëtar

(                    )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 79 Datë 02.05.2008**

**Për**

**Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi pjesën prej 67 % të kapitalit aksionar në Media Vizion Sh.A nga shoqëritë Spot AG & Ost'holding GmbH**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.05.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi pjesën prej 67 % të kapitalit aksionar në Media Vizion Sh.A nga shoqëritë Spot AG & Ostholding GmbH.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” neni 5.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretariatit mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesës prej 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion Sh A, nga shoqëritë Spot AG dhe Ost Holding GmbH.

**V Ë R E N S E:**

- 1. Palët e përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në transaksion:**

- 1.1 Media Vizion Sh A me qendër në Tiranë, Shqipëri, e licensuar për ofrimin e shërbimeve radio-televizive, në tregun kombëtar, është **shitësi** i pjesës prej 67% të kapitalit aksionar të shoqërisë;
- 1.2 - Spot AG, me qendër në Vienë, Austri, me veprimtari shitblerje dhe administrim aksionesh, dhe  
- Ost Holding GmbH, me qendër në Vienë, Austri, me veprimtari shitblerje dhe administrim aksionesh;

janë **blerësit/përfthuesit e kontrollit** për pjesën 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion ShA.

2. Marrëveshja e shitblerjes, e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në datën 20 Mars 2008, ka për objekt përfthimin e kontrollit të përbashkët nga shoqëritë Ost Holding dhe Spot AG, nëpërmjet blerjes së 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion Sh.A është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 28.03.2008, në përputhje me afatin ligjor të parashikuar në nenin 12, pika 2 e Ligjit.
3. Ky transaksion që realizon në mënyrë të drejtëpërdrejtë “përfthimin e kontrollit”, në kuptim të nenit 10, pika 1 dhe 2, konsiderohet si përqendrim.
4. Transaksion duhet t’i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimit të parashikuar në Kreun e IV të Ligjit, me kusht që ky të përmbushë në mënyrë kumulative edhe kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja a) dhe b) të nenit 12 të Ligjit.
5. Xhiro totale e palëve blerëse në tregun ndërkombëtar:
  - për vitin 2006 është: 561, 4 milion lekë
  - për vitin 2007 është 976,5 milion lekë; dhe

Xhiro totale e shitësit në tregun e brendshëm:

- Për vitin 2006 është: 157 milion lekë
  - Për vitin 2007 është: 295.3 milion lekë
6. Referuar informacioneve për xhiron ndërkombëtare dhe atë kombëtare të realizuar për vitin paraardhës të transaksionit dhe deklaruar nga palët pjesëmarrëse, transaksioni i njoftuar nuk plotëson kushtin e parashikuar në nenin 12, pika 1 e ligjit.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 5 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

**VENDOSI:**

1. Njoftimi i përqendrimit “Për përfitim të kontrollit të përbashkët mbi 67% të kapitalit aksionar në shoqërinë Media Vizion ShA, me seli në Shqipëri, nga shoqëritë Spot Holding AG dhe Ost Holding GmbH, me seli në Austri, për shkak të mosplotësimit të kritereve të përcaktuara në nenin 12, pika 1 shkronjat a) dhe b) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nuk konsiderohet përqendrim që duhet të autorizohet nga ana e Komisionit të Konkurrencës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

( )

( )

( )

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**  
**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 80 Datë 05.06.2008**

**Mbi**

**Miratimin e rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.06.2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përmirësimin e procedurave që ndjek Autoriteti i Konkurrencës për Kontrollin e Përqendrimeve.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d), dh), si dhe nenin 84.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,

**V Ë R E N S E:**

Në zbatim të angazhimeve të përcaktuara në Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Europian, përvojës së Autoritetit të Konkurrencës në fushën e kontrollit të përqendrimeve, me qëllim rritjen e efikasitetit në kontrollin e përqendrimeve lindi si domosdoshmëri rishikimi i akteve nënligjore në këtë fushë.

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d) dhe shkronja dh) dhe 84, shkronja ç, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Rregulloren “Për zbatimin e procedurave të njoftimit të përqendrimeve”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, të miratuar me Vendimin Nr. 7 datë 1.6.2004 të Komisionit Konkurrencës, shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar(\_\_\_\_\_)  
Anëtar(\_\_\_\_\_)  
Anëtar**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**

---

**RREGULLORE**

**PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRQENDRIMIT TË  
NDËRMARJEVE**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME**

**Neni 1**

**Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt zbatimin e procedurave për kontrollin e përqendrimeve të ndërmarrjeve, në përputhje me Ligjin Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ( i ndryshuar).

**Neni 2**

**Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha përqendrimet në formën e bashkimeve juridike dhe faktike të dy ose më shumë ndërmarrjeve, përfshirë të kontrollit mbi një ose më shumë ndërmarrje, krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët, të përcaktuara në nenin 10 dhe që plotësojnë kushtet e nenit 12, pika 1 të Ligjit.

**Neni 3**

**Përkufizime**

Në këtë rregullore, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Ligj” nënkuptohet Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).
2. “Ditë Pune” do të thotë të gjitha ditët përveç të Shtunës, të Dielës, dhe festave zyrtare.

3. “Pala ose palët në përqendrim” i referohet si palës blerëse ashtu edhe palës të blerë, ose palëve që bashkohen, ose palës subjekt i një oferte publike.

#### **Neni 4**

##### **Barra e Provës**

Pala që paraqet njoftimin për përqendrim është e detyruar që të paraqesë përpara Autoritetit të gjitha të dhënat dhe provat e nevojshme mbi të cilat mbështet pretendimet e saj.

#### **Neni 5**

##### **Vlerësimi i përqendrimeve**

1. Për vlerësimin e përqendrimeve Komisioni mban parasysht nevojën për të mbrojtur dhe zhvilluar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg, duke pasur parasysht strukturën e këtij tregu dhe konkurrencën aktuale ose potenciale të ndërmarrjeve që veprojnë në këtë treg.
2. Komisioni, në përputhje me nenin 56 të Ligjit, autorizon përqendrimin që nuk kufizon ndjeshëm konkurrencën efektive, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të një pozicioni dominues, në tregun e brendshëm ose në një pjesë të ndjeshme të tij.
3. Komisioni, në zbatim të nenit 13 të Ligjit, ndalon përqendrimin i cili kufizon në mënyrë të ndjeshme konkurrencën në treg ose në një pjesë të tij, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

## **KREU II**

### **NJOFTIMET DHE DOKUMENTACIONI SHOQËRUES**

#### **Neni 6**

##### **Konsultimet para njoftimit**

1. Nëse ndërmarrjet shprehin interesin për të realizuar një marrëveshje e cila sjell krijimin e një përqendrimi, ato mund të informojnë dhe të konsultohen pranë Autoritetit të Konkurrencës.
2. Sekretari i Përgjithshëm, me marrjen në dijeni të përqendrimit të mundshëm, konsulton palët për procedurat e mëtejshme, duke kërkuar një informacion me shkrim.
3. Informacioni duhet të përmbajë të dhëna për palët pjesëmarrëse si:
  - a) emrin dhe adresën e ndërmarrjes;
  - b) natyrën e veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes;
  - c) emrin e personit të kontaktit apo përfaqësuesit të ndërmarrjes, adresën, numrin e telefonit/ faksit, postës elektronike;

- d) Formën dhe objektin e transaksionit;
  - e) të dhëna të plota financiare (xhirot) për të treguar që transaksioni i synuar përmbush ose jo kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Ligjit.
4. Sekretariati mund të përjashtojë nga detyrimi për dhënien e ndonjë informacioni të veçantë atëherë kur ky informacion disponohet nga Autoriteti.
  5. Palët pjesëmarrëse informojnë Autoritetin në rast të mos realizimit të marrëveshjes ose njoftimit të ofertës publike.

### **Neni 7**

#### **Detyrimi për njoftimin e përqendrimit**

Nëse palët kanë përfunduar një marrëveshje për bashkim, përfitim kontrolli, krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët, ose kanë publikuar një ofertë publike për blerje ose përfitim kontrolli, duhet ta njoftojnë atë pranë Autoritetit në zbatim të nenit 12 dhe 53, pika 2 të Ligjit.

### **Neni 8**

#### **Personat e autorizuar për paraqitjen e njoftimit**

1. Njoftimet duhet të paraqiten nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në një përqendrim, nga përfaqësues të tyre të pajisur me autorizimin përkatës, ose nga përfaqësuesit Ligjor të përfaqësuar me prokurë.
2. Në rastin e bashkimit apo përftimit të kontrollit, njoftimi kryhet nga blerësi, përftuesi i kontrollit dhe në rastin e publikimit të ofertës publike, nga ofertuesi.
3. Njoftimet e përbashkëta duhet të dorëzohen në një formë të vetme. Njoftimin mund të kryhet nga një përfaqësues i përbashkët, i cili është i pajisur me një prokurë, në të cilin përcaktohet e drejta e përfaqësimit për llogari të ndërmarrjeve pjesëmarrëse.
4. Palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre i japin Autoritetit një adresë për komunikim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ku mund të dërgohet e gjithë korrespondenca.

### **Neni 9**

#### **Paraqitja e njoftimeve**

1. Njoftimet duhet të plotësohen sipas kërkesave të Formularit për Njoftimin e Përqendrimit në Formën e Thjeshtuar sipas Udhëzimit përkatës të Autoritetit të Konkurrencës.
2. Sekretariati argumenton dhe vlerëson me shkrim nëse plotësohen kriteret për përdorimin e formularit të thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit sipas Udhëzimit përkatës të Autoritetit të Konkurrencës. Në rast se këto kritere nuk përmbushen, i kërkon palëve përdorimin e formularit të plotë të njoftimit të përqendrimit.

3. Palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre në një dokument të veçantë duhet të përcaktojnë në mënyrë të qartë informacionet që ata konsiderojnë se përmbajnë sekrete biznesi.
4. Informacioni duhet të jetë i saktë dhe i plotë.

### **Neni 10**

#### **Dorëzimi i dokumentacionit**

1. Dy kopje origjinale ose të njehsuara me origjinalen të secilit njoftim dhe të dokumenteve të bashkëlidhur (të përcaktuara në formularin e njoftimit), duhet të dorëzohen në Zyrën e Arkiv Protokollit të Autoritetit të Konkurrencës.
2. Njoftimi duhet të përmbajë një listë përshkrimore të dokumentacionit bashkëlidhur si dhe numrin e faqeve përkatëse të tyre.
3. Nëse dokumentacioni përkatës është në gjuhë të huaj, pala njoftuese paraqet një kopje të shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe e cila mban dhe vërtetimin noterial për saktësinë e këtij përkthimi.
4. Pranimi i njoftimit dhe i dokumenteve bashkëlidhur atij duhet bërë gjatë orarit zyrtar të punës, në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rruga “Sami Frashëri” Nr 4, kati IV, Tiranë, Shqipëri.

### **Neni 11**

#### **Data kur njoftimi bëhet efektiv**

1. Njoftimet bëhen efektive në datën kur ato dorëzohen në sektorin përgjegjës për mbajtjen e Arkivës e Protokollit të Autoritetit të Konkurrencës.
2. Sekretariati, bazuar në nenin 54 të Ligjit u konfirmon me shkrim ndërmarrjeve ose përfaqësuesve të tyre se njoftimi është i plotë ose jo. Në rast se njoftimi është i plotë, afati i parashikuar në nenin 56 të Ligjit fillon në ditën e punës pasardhëse të ditës së njoftimit me shkrim të ndërmarrjeve ose përfaqësuesve e tyre.
3. Nëse njoftimi nuk është i plotë, Sekretariati njofton palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre me shkrim dhe pa vonesë, duke caktuar një afat kohor, jo më pak se 15 ditë pune, për plotësimin e informacionit. Në të tilla raste, afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, fillon në datën në të cilën Autoriteti ka siguruar informacionin e plotë.
4. Sekretariati, në zbatim të nenit 55, pika 1 të Ligjit, mund të kërkojë të dhëna dhe dokumente të tjera shtesë nga palët njoftuese, përfaqësuesit e tyre, apo palë të treta të interesuara, në çdo kohë të procedurës së njoftimit brenda një afati të përcaktuar prej tij, të nevojshëm për vlerësimin e përqendrimit të njoftuar.
5. Palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre, për çdo ndryshim në informacionet dhe dokumentet bashkëlidhur njoftimit, për të cilat kanë apo mund të kenë dijeni, duhet të njoftojnë Autoritetin. Në të tilla raste, kur këto ndryshime mund të kenë një efekt

të rëndësishëm në shqyrtimin e përqendrimit, afati i parashikuar në nenin 56 të Ligjit fillon në datën në të cilën Autoriteti ka marrë informacion mbi ndryshimet.

6. Informacioni jo i saktë, dhe i shtrembëruar konsiderohet si informacion jo i plotë në bazë të nenit 33 i Ligjit dhe përbën shkak për vendosje gjobe sipas nenit 73 të Ligjit.

### **KREU III**

#### **SHQYRTIMI I NJOFTIMI, FILLIMI I PROCEDURAVE DHE AFATET KOHORE**

##### **Neni 12**

###### **Informimi i Komisionit**

Sekretariati informon me shkrim Komisionin për fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit. Informacioni përmban datën e saktë të dorëzimit të njoftimit dhe dokumenteve të bashkëlidhura, llojin e formularit të njoftimit të plotësuar nga palët njoftuese apo përfaqësuesit e tyre, si dhe datën e konfirmimit të njoftimit.

##### **Neni 13**

###### **Publikimi i procedurës paraprake**

Sekretariati publikon fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës [caa.gov.al](http://caa.gov.al). Akti i publikimit përmban të dhënat për palët pjesëmarrëse, vendin e tyre të origjinës, formën e përqendrimit, sektorët e ekonomisë së përfshirë në të, ftesën e Autoritetit të Konkurrencës për shprehjen e komenteve nga palët e interesuara dhe afatin e fundit për shprehjen e këtyre komenteve.

##### **Neni 14**

###### **Fillimi i afateve kohore**

1. Afati 2 muajor për kryerjen e procedurës paraprake të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit fillon ditën e punës pas ditës së konfirmimit të njoftimit.
2. Afati 3 muajor për kryerjen e procedurës së thelluar të përcaktuar në nenin 57 të Ligjit fillon ditën e punës pas datës kur Komisioni merr vendim për fillimin e procedurës së thelluar.

##### **Neni 15**

###### **Përfundimi i afatit**

1. Afati dy muajor për kryerjen e procedurës paraprake do të përfundojë me kalimin e asaj dite të muajit të dytë, që ka të njëjtën datë si dita që ka filluar afati. Kur ai muaj nuk e ka këtë datë atëherë afati do të mbarojë me kalimin e ditës së fundit të atij muaji.

2. Afati tre-mujor për kryerjen e procedurës së thelluar do të përfundojë me kalimin e ditës së muajit të tretë në vazhdim, që ka të njëjtën datë si dita që ka filluar afati. Kur ai muaj nuk e ka këtë datë atëherë afati do të mbarojë me kalimin e ditës së fundit të atij muaji.
3. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi ose festë zyrtare, afati do të mbarojë në ditën e punës që vjen pas asaj të pushimit, ose festës zyrtare.

## **Neni 16**

### **Festat zyrtare**

Nëse afati, i llogaritur sipas nenit 14 të kësaj Rregullore, ka mbaruar dhe nëse festat zyrtare ose festat e tjera bien brenda periudhave të referuara në nenin 56 dhe 57 të Ligjit, një numër i njëjtë ditësh pune do t'iu shtohet këtyre periudhave.

## **Neni 17**

### **Pezullimi i afatit kohor**

1. Periudhat e referuara në nenin 57 të Ligjit do të pezullohen kur Komisioni, në bazë të nenit 33, pika 2 të Ligjit, duhet të marrë një vendim sepse:
  - a. Informacioni të cilin Sekretariati, në bazë të nenit 55 të Ligjit, e ka kërkuar nga njëra prej palëve njoftuese ose prej palëve të tjera të interesuara, nuk është dhënë ose nuk është dhënë i plotë brenda afatit kohor të përcaktuar prej tij;
  - b. Një nga palët njoftuese ose palët e tjera të interesuara ka refuzuar dhënien e informacionit ose ka refuzuar bashkëpunimin me Sekretariatit për sigurimin e informacionit të kërkuar në bazë të nenit 55, që Sekretariati e konsideron të rëndësishëm;
  - c. Palët njoftuese kanë dështuar në informimin e Autoritetit për ndryshimet e fakteve që përmban njoftimi.
2. Afatet e përcaktuara në nenin 57 të Ligjit do të pezullohen:
  - a. në rastet e referuara në pikën 1 (a) dhe (b) të këtij neni, për periudhën ndërmjet fundit të afatit kohor të caktuar në kërkesën për informacion dhe marrjes së informacionit të plotë dhe të saktë të kërkuar me vendim të Komisionit;
  - b. në rastet e referuara në pikën 1 (c) të këtij neni, për periudhën ndërmjet ndryshimit të fakteve dhe marrjes së informacionit të saktë dhe të plotë të kërkuar me vendim të Komisionit.
3. Pezullimi i afatit kohor fillon në ditën pasardhëse të Vendimit përkatës të Komisionit. Pezullimi përfundon kur janë zhdukur pengesat që e kanë shkaktuar atë.

## **Neni 18**

### **Përputhshmëria me afatet kohore**

Afatet kohore të përcaktuara në nenet 56 dhe 57 të Ligjit do të konsiderohen të plotësuar



nëse Komisioni i Konkurrencës ka marrë vendimin përkatës para përfundimit të këtyre afateve.

## **KREU IV PROCEDURAT PËR VENDIM-MARRJE**

### **Neni 19**

#### **Palët që mund të dëgohen**

1. Përpara marrjes së një vendimi, në plotësimin e kushteve të neneve 56, pika 2 dhe 57 të Ligjit dhe në bazë të nenit 39 të Ligjit, Komisioni u krijon mundësi për tu dëgjuar palëve njoftuese dhe palëve të treta që lidhen me përqendrimin e njoftuar.
2. Përveç palëve të përcaktuar në nenin 8 pika 2 të kësaj rregulloreje, kanë të drejtën për t'u dëgjuar:
  - (a) palët e tjera të përfshira, përveç palëve njoftuese, të tilla si shitësi dhe ndërmarrja e cila është objekt i përqendrimit;
  - (b) palët e treta të interesuara, që mund të jenë personat fizikë ose juridikë, përfshirë konsumatorët, furnitorët, konkurrentët dhe veçanërisht anëtarët e organeve të administratës ose manaxheriale të ndërmarrjeve në fjalë ose përfaqësuesit e sindikatave të këtyre ndërmarrjeve.
  - (c) palët ndaj të cilave Komisioni i Konkurrencës mendon të marrë një vendim në bazë të nenit 73, 74 dhe 76 të Ligjit.

### **Neni 20**

#### **Seanca dëgjimore**

1. Komisioni u krijon mundësi palëve njoftuese dhe palëve të interesuara që të paraqesin verbalisht argumentet e tyre në një seancë dëgjimi, nëse e kanë kërkuar këtë gjë në komentet e tyre me shkrim dhe nëse ato janë të interesuara. Komisioni mund t'u japë palëve mundësinë që t'i shprehin pikëpamjet e tyre verbalisht, edhe në raste të tjera kur ai e sheh të nevojshme.
2. Komisioni fton me shkrim palët që do të dëgohen që të jenë pjesëmarrëse në datat e vendosura për seancën e dëgjimit.
3. Palët e ftuara për të marrë pjesë duhet të paraqiten personalisht ose të përfaqësohen nga përfaqësues i autorizuar. Ndërmarrjet dhe grupet e ndërmarrjeve mund të përfaqësohen edhe nga një person i përbashkët autorizuar.
4. Seancat e dëgjimit, si rregull janë të mbyllura për publikun dhe regjistrohen. Komisioni mund të vendosë për organizimin e seancave të hapura për publikun.
5. Çdo palë mund të dëgohet veçmas ose në prezencën e palëve të tjera të ftuar për të marrë pjesë, duke mbajtur në konsideratë interesin legjitim të ndërmarrjeve për mbrojtjen e sekreteve të tyre të biznesit dhe informacione të tjera konfidenciale.

## Neni 21

### Vendimet për autorizimin e realizimit të përkohshëm të përqendrimit

1. Në ato raste kur Komisioni mendon të marrë një vendim në bazë të nenit 60 të Ligjit, i cili ka pasoja për një ose më shumë palë, njofton me shkrim palët njoftuese dhe palët e tjera të përfshira, lidhur me vërejtjet e tij dhe cakton një afat kohor brenda së cilit ato mund të japin pretendimet e tyre shkresërisht dhe në seancë dëgjimore.
2. Kur palët njoftuese dhe palët e tjera të interesuara kanë paraqitur pretendimet e tyre, Komisioni merr vendim në lidhje me këtë përqendrim.
3. Në rast të mosparaqitjes së palëve në seancë dëgjimore dhe/ose të mosparaqitjes së pretendimeve të tyre me shkrim brenda afateve të përcaktuara në pikës 1 të këtij neni, Komisioni i njofton me shkrim për vendimin e marrë brenda 5 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

## Neni 22

### Afatet kohore të angazhimeve

1. Angazhimet e propozuara Autoritetit nga palët sipas nenit 56, pika 2 të Ligjit, për të cilat palët mendojnë se mund të shërbejnë si bazë për vendimin duhet të paraqiten pranë Autoritetit jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e marrjes së njoftimit.
2. Angazhimet e propozuara Autoritetit nga palët pjesëmarrëse sipas nenit 57, pika 2 të Ligjit, për të cilat palët mendojnë se mund të shërbejnë si bazë për vendimin duhet të paraqiten pranë Autoritetit jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data kur ka nisur procedura e thelluar.
3. Përcaktimet e bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen në përputhje me këtë Rregullore.

## Neni 23

### Procedura për angazhimet

1. Një kopje origjinale e angazhimeve të propozuara për Autoritetin nga ndërmarrjet sipas neneve 56, 57 të Ligjit duhet të paraqiten pranë Autoritetit në adresën zyrtare të tij.
2. Çdo palë që propozon angazhime pranë Autoritetit do të identifikojë qartë çdo dokument (apo të dhënë) i cili konsiderohet si konfidencial, të japë arsyet për këtë dhe të sigurojë një version tjetër jo-konfidencial brenda afatit kohor të vendosur nga Autoriteti.

## Neni 24

### Marrja e vendimeve dhe dëgjimi i palëve

1. Nëse Komisioni mendon të marrë një vendim sipas neni 56, pika 1, u krijon mundësi për tu dëgjuar, palëve njoftuese dhe palëve të tjera të interesuara ose përfaqësuesit

e tyre për çështjen në fjalë.

2. Komisioni i paraqet me shkrim vërejtjet e tij palëve njoftuese, palëve të tjera të interesuara ose përfaqësuesve e tyre dhe cakton një afat kohor brenda së cilit ata mund të paraqesin me shkrim pretendimet e tyre.
3. Palëve të cilave iu janë drejtuar vërejtjet e Komisionit ose ato që janë njoftuar për këto vërejtje, brenda afatit kohor të përcaktuar, japin me shkrim pretendimet e tyre si dhe për ti vërtetuar ato, mund të bashkëlidhin çdo dokument të mundshëm. Palët mund t'i propozojnë Komisionit dëgjimin e personave të cilët mund të vërtetojnë këto pretendime.
4. Procedurat e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohen ndaj palëve sipas përcaktimit të bërë në nenin 19 pika 2 shkronja c, të kësaj rregulloreje.

### **Neni 25**

#### **Vendimet e Komisionit**

1. Kur Komisioni merr vendim se transaksioni i njoftuar nuk përbën një përqendrim sipas nenit 10 dhe 12 të Ligjit, Autoriteti duhet të njoftojë me shkrim palët njoftuese ose përfaqësuesit e tyre, në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 56 të Ligjit.
2. Kur Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar nuk krijon ose forcon pozitën dominuese, ai e autorizon atë në zbatim të nenit 56, pika 1 në kuptim të fjalisë së parë të Ligjit.
3. Kur Komisioni konstaton se përqendrimi i njoftuar shfaq shenja të krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, në zbatim të nenit 56, pika 1 të Ligjit, në kuptim të fjalisë së dytë, vendos fillimin e procedurave të thelluar të kontrollit të përqendrimit ose autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime.
4. Kur Komisioni verën se përqendrimi i ndërmarrjeve është kryer në shkelje të detyrimit për njoftim, vendos me nismën e vet fillimin e procedurave të kontrollit të përqendrimit.

### **Neni 26**

#### **Publikimi i vendimeve**

Vendimet e Komisionit publikohen në Buletinin Zyrtar si dhe në faqen zyrtare të internetit Autoritetit të Konkurrencës.

## **KREU V DISPOZITA TË TJERA**

### **Neni 27**

#### **Dërgimi i dokumenteve**

Dokumentet dhe ftesat nga Autoriteti për tek të adresuarit dërgohen në një nga këto mënyra:

- a. Letër e regjistruar me konfirmimin e marrësit;
- b. Faks me kërkesë për dhënien e konfirmimit nga marrësi;
- c. Postë elektronike me një kërkesë për dhënien e konfirmimit nga marrësi.

### **Neni 28**

#### **Vendosja e afateve kohore**

1. Në vendosjen e afateve kohore, Autoriteti do të ketë parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e formularëve dhe urgjencën e çështjes.
2. Këto afate kohore do të vendosen mbi bazë kalendarike, duke marrë parasysh ditët e festave zyrtare.

### **Neni 29**

#### **Shfuqizime**

Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve:” miratuar me Vendimin nr. 7, datë 1.6.2004 të Komisionit të Konkurrencës shfuqizohet.

### **Neni 30**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Komisioni i Konkurrencës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 81 Datë 10.06.2008**

**Për**

**“Përjashtimin nga Ndalimi i Marrëveshjes së lidhur midis American Express Limited (AMEX) dhe ALPHA BANK A.E”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.06.2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përjashtimin nga ndalimi i Marrëveshjes së lidhur midis American Express Limited dhe Alpha Bank A.E.

Baza ligjore: Ligji Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 49 dhe neni 50 pika 1.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Për përjashtimin e marrëveshjes midis American Express Limited dhe Alpha Bank A.E dhe relacionit të Sekretares së Përgjithshme;
- Marrëveshjes ““American Express Independent Agreement” me Alpha Bank AE;
- Formularit për njoftimin e marrëveshjes

**V Ë R E N S E:**

Më datë 11.03.2008, Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 49, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” ka marrë njoftimin nga Alpha

Bank Shqipëri, për përjashtimin nga ndalimi të Marrëveshjes “**American Express, Independent Agreement**” të lidhur më datë 14 Gusht 2007.

### **I. Palët në marrëveshje**

- **Licensuesi, American Express** është një markë e mirënjohur në industrinë e kartave të kreditit me adresë në New York, SHBA. Kjo markë operon në mbarë botën. Në disa vende ajo ofron shërbime të drejtpërdrejta të kartës, por në disa vende të tjera ajo hyn në treg duke kontraktuar banka.
- **Licencuari, Alpha Bank** është krijuar si Degë e Bankës Alpha në Greqi, me adresë në Tiranë, Bulevardi Zogu i parë nr. 47 në përputhje me Ligjin “ Për Bankat “ Nr. 9662 datë 18.12.2006.

### **II. Përshkrimi i marrëveshjes**

Nëpërmjet kësaj marrëveshje Alpha Bank Albania autorizohet nga AMEX të drejtojë shërbimin e kartave të saj në vend (Shqipëri). Kjo përfshin licencën ekskluzive që për 5 vjet Alpha Bank Albania:

- a) të veprojë si Emetues në Vend (Shqipëri) për kartat AMEX në monedhën vendase (Lek);
- b) të veprojë si Përvetësues në Vend (Shqipëri), për të lidhur kontrata me Persona në Vend (Shqipëri), kur këta persona bien dakord të bëhen ndërmarrës të shërbimeve vendore.
- c) të bëhet pjesë e shërbimit të kartës në vend (Shqipëri).

Të drejtat e të Licencuarit për të emetuar Karta në monedhën vendase (Lek), duke përdorur Markat e licencuara AMEX të referuara në Marrëveshjen e Licencës së Markave Tregtare do të jenë ekskluzive vetëm për përdorim në monedhën vendase (Lek) brenda territorit të Shqipërisë dhe vetëm për:

- (i) Kartat e Kreditit American Express Gold;
- (ii) Kartat e Kreditit American Express (Green)
- (iii) Kartat American Express Gold Busines.

Këto të drejta i Licencuari i ka vetëm për një afat 5 vjeçar.

Në sistemin bankar shqiptar kartën American Express e ofron Banka Amerikane dhe Banka Credins por vetëm në valute (në euro ose dollarë) dhe kjo marrëveshje nuk i pengon ato të vazhdojnë ofrimin e këtyre kartave.

Në kushtet e kontratës parashikohet se të drejtat e fituara nga i Licencuari, me kontratë janë të pa transferueshme pra vetëm AMEX ka të drejtën ekskluzive për të përcaktuar llojet e kartave që i Licencuari do të përdorë.

Sipas kontratës i Licencuari do të veprojë si vetëmenaxhues dhe jo si Agjent i AMEX, që do të thotë se kjo marrëveshje nuk synon të krijojë marrëdhënie partneriteti ose shoqëri të përbashkët ndërmjet AMEX dhe të Licencuarit

### **III. Tregu përkatës**

#### **III.1. Tregu përkatës i produktit**

Marrëveshja midis Amerikan Express dhe Bankës Alpha përcakton si produkt të saj kartat e kreditit.

Karta e kreditit, është një shërbim për kryerje pagese jo-cash që ofrohet me anë të kartës duke i ofruar klientit mundësinë e kryerjes së pagesës pa patur gjendje në llogari. Kjo, për vetë natyrën e veçantë të kartave të kreditit paraqitet si një lloj kredie afatshkurtër ku interesi që aplikohet për to është më i lartë se për kreditë e tjera. Alpha Bank A.E. do të emetojë: Kartat e Kreditit American Express Gold, Kartat e Kreditit American Express (Green) dhe Kartat American Express Gold Business në lekë.

#### **III.2. Tregu përkatës gjeografik**

Marrëveshja e nënshkruar parashikon që Alpha Bank Albania, do të emetojë dhe përvetësojë kartat e Amerikan Express pa kufizim brenda territorit të Shqipërisë. Fillimisht ky shërbim do të ofrohet në qytetin e Tiranës dhe të Durrësit dhe për vitet e ardhshme parashikohet zgjerimi i saj në të gjithë vendin. Alpha Bank operon me 23 degë 1 agjenci . Degët e saj janë të shtrira në qytet Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë dhe Berat.

### **IV. Tregu i kartave të kreditit/debitit**

Deri më tani në Shqipëri janë emtuar 14,564 Karta Krediti. Kartat e kreditit mund të emtohen në monedhë vendase (lekë) ose në monedhë të huaj (euro ose dollarë). Pavarësisht nga monedha e përcaktuar gjatë emetimit, kartat e kreditit mund të mbulojnë pagesa edhe në monedha të tjera, sipas kursit të këmbimit të aplikuar nga banka emetuese.

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, në sistemin bankar operojnë 12 banka si emetuese të kartave të debitit dhe 7 banka si emetuese të kartave të kreditit. Kartat e kreditit zënë rreth 2.23% në totalin e kartave dhe numri i transaksioneve nga këto karta zë rreth 3.8% në totalin e transaksioneve. Raiffeisen Bank zë pjesën më të madhe të tregut të kartave të debitit me rreth 56.3% kurse Alpha Bank AE në këtë treg zotëron rreth 1.6%. Në tregun Kartave të kreditit Banka Kombëtare Tregtare zotëron rreth 53.5% të kartave të emetuara dhe Alpha Bank zotëron vetëm 2.3%.

### **V. Analiza e Konkurrencës**

V.1. Zevendesueshmeria nga ana e kërkesës. Karta e kreditit AMEX, në lekë, e emtuar nga Alpha Bank, ka zëvendësuesin e saj më të afërt kartat Master Card në lekë e emtuar nga BKT dhe Visa Card në lekë e emtuar e Tirana Bank. Megjithatë edhe kartat në monedhë të huaj, janë zëvendësues të kësaj karte pasi e vetmja kosto shtesë që mund të ketë ky shërbim është komisioni i konvertimit.

V.2. Zevendesueshmeria nga ana e ofertës. Duke qenë se marrëveshja në fjale është ekskluzive, asnjë bankë tjetër nuk mund të ofrojë këtë kartë krediti në monedhën vendase, por mund të synojnë emra të tjerë prestigjioz konkurrues në sistemin e kartave si janë Visa ose Master Card.

### V.3. Hyrje të reja në treg

Tregu duket në hapat e para dhe i hapur për hyrje të reja. Gjatë vitit 2008, Banka Credins do të sjellë një prurje të re në tregun e Kartave në Shqipëri, sepse ajo do të hedhë kartën e saj VISA Card, Banka Tirana, gjatë 2008, po përgatitet të përvetësojë shërbimin e Master Card; Banka Kombëtare Tregtare (BKT) po fillon të emetojë Kartat Visa dhe Banka Popullore përgatitet të emetojë Master Cards.

### V.4. Zhvillimet në konkurrencë

Zbatimi i marrëveshjes me American Express në tregun shqiptar do të kontribuojë në:

1. Rritjen e ofertës në tregun e kartave;
2. Produkte të reja, të sofistikuar dhe më cilësore që do të rrisin shumëllojshmërinë e tregut;
3. Hyrjen e një marke të re në treg, ofrimin e një produkti të ri dhe çmime të reja sipas nevojave të klientëve;
4. Strategji të reja shpërndarje, do të ndiqen për të tërhequr dhe mbajtur klientët;
5. Teknologjitë e kërkuara në zhvillimin e këtyre produkteve janë gjithashtu risi në tregun e kartave, që do të thotë zhvillim në mjedisin teknologjik.
6. Për përdoruesit e kësaj karte, do të ofrohen bonuse.

Zbatimi i kësaj marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në treg, në shërbimin ndaj klientëve dhe në zhvillimet e mëtejshme të metodave të pagesës.

### V.5. Kufizimet e konkurrencës

- Marrëveshja e eskuzivitetit të kartës AMEX përfshin ofrimin e shërbimit vetëm nga një bankë, por kjo nuk pengon ofrimin e këtij shërbimi nga banka të tjera dhe me licencues të tjerë (psh siç janë Visa dhe Master card).

Në kushtet aktuale të sistemit tonë bankar, ku Alpha Bank nuk ka peshë të madhe në tregun bankar dhe në këtë produkt, nuk pritët që kjo marrëveshje të shkaktojë efekte antikonkurrese.

- Liria tregtare e blerësit, e të licencuarit ose e ndërmarrjeve të tjera nuk kufizohet, sepse të njëjtin produkt dhe shërbim atyre mund tu ofrohet nga kompanitë e tjera Master dhe Visa.
- Tregu i kartave të kreditit dhe debitit në Shqipëri është në fazat e para të zhvillimit dhe hyrja e kartës American Express pritët të nxisë konkurrencën në treg.

## PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 7, pika 1 dhe nenit 50 të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”;



**VENDOSI:**

1. Të përjashtojë për 5(pesë) vjet, nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Marrëveshjen e Liçencës “American Express, Independent Agreement” të lidhur më datë 14 Gusht 2007 midis American Express Limited (AMEX) dhe Alpha Bank A.E.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 82 Datë 23.06.2008**

**Mbi**

**Miratimin e Udhëzimit “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit”  
si dhe anekset përkatës I dhe II të bashkëlidhur.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.06.2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimi i Udhëzimit “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d), dh) dhe neni 53, pika 3, si dhe Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” miratuar me vendimin Nr. 80, Datë 5.6.2008 të Komisionit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Udhëzimit “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit” si dhe anekset përkatëse I dhe II (Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimeve, si dhe Formulari i Plotë i Njoftimit të Përqendrimeve) bashkëlidhur.

**V Ë R E N S E:**

Në zbatim të praktikave më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian, përvojës së deritanishme të Autoritetit të Konkurrencës në fushën e kontrollit të përqendrimeve, me qëllim sqarimin e mënyrës dhe llojit të informacionit që duhet siguruar nga pala njoftuese

në rast të njoftimit të një përqendrimi, për marrje autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës, lindi si domosdoshmëri rishikimi i akteve nënligjore në këtë fushë.

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d) dhe shkronja dh) si dhe neni 53, pika 3 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

### **VENDOSI:**

1. Të miratojë Udhëzimin “Mbi formën e njoftimit të përqendrimit” së bashku me anekset I dhe II, Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimeve dhe Formulari i Plotë i Njoftimit të Përqendrimeve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe për mundësinë për njoftim të thjeshtuar”, të miratuar me Vendimin Nr. 8 datë 1.6.2004 të Komisionit Konkurrencës, shfuqizohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

( )  
Zv/Kryetar

( )  
Anëtar

( )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**KRYETARE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 83 Datë 02.07.2008**

**Per Miratimin e  
“Rregullores së brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave në  
ushtrimin e funksioneve publike në Autoritetin E Konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.07.2008, ne mbeshtetje te nenit 24 te Ligjit nr. 9121, date 28.07.2003 “Per mbrojtjen e Konkurrences“, nenit 46 te Ligjit nr. 9367, date 07.04.2005 “ Per Parandalimin e Konfliktit te Interesave ne Ushtrimin e Funksioneve Publike“, me propozim te Sekretarit te Pergjithshem;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e “Rregullores se Brendshme per Parandalimin e Konfliktit te Interesave ne Ushtrimin e Funksioneve Publike ne Autoritetin e Konkurrences”, bashkelidhur ketij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali  
(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar

Servete Gruda  
(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

Koço Broka  
(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

**KRYETARE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**

---

**RREGULLORE E BRENDSHME**

**PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË  
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE NË AUTORITETIN E  
KONKURENCËS**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet dhe miratohet në bazë të nenit 46, pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, nenit 24 germa dh) të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar dhe nenit 5 pika 1 të Rregullores “Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

**Neni 2**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave dhe procedurave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave si dhe sanksionet për shkeljen e kësaj rregulloreje.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

1. Në kuptim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këto përkufizime:
  - a) **“Zyrtar”** është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron kompetenca në pozicionet: Kryetar i Komisionit të Konkurrencës, Zv/kryetar i Komisionit të Konkurrencës, Anëtar i Komisionit të Konkurrencës, Drejtor Kabineti pranë Komisionit të Konkurrencës, punonjës të Kabinetit të Komisionit të Konkurrencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie pranë Sekretariatit, Përgjegjës Sektori pranë Drejtorisë përkatëse dhe Specialist pranë Sektorit përkatës.

- b) **“Epror i një zyrtari”** në kuptimin e kësaj rregulloreje është sipas hierarkisë, Komisioni i Konkurrencës, Kryetari i Komisionit të Konkurrencës, Zv/kryetari i Komisionit të Konkurrencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtor Kabineti dhe drejtorët e Drejtorive pranë Sekretariatit, që kanë kompetenca vendimmarrëse, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese të drejtpërdrejta mbi zyrtarin, ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara në zbatim të ligjit.
- c) **“Person i lidhur me një zyrtar”** është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore me zyrtarin, sipas nenit 5 të Ligjit.
- d) **“Parim i proporcionalitetit”** është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari të Autoriteti të Konkurrencës me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.
- e) **“Konflikt i interesit”** është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike. Konflikti i interesit, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:
- i) **“Konflikt rast për rast interesi”** është gjendja me konflikt interesi në njërin nga tri llojet e mëposhtme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë;
  - ii) **“Konflikt faktik i interesit”** është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit;
  - iii) **“Konflikt në dukje interesi”** është gjendja në të cilën interesat e zyrtarit duken në pamje ose në formë sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të zyrtarit
  - iv) **“Konflikt i mundshëm interesi”** është gjendja në të cilën interesat e zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.
- f) **“Ligj”** në kuptimin e kësaj rregulloreje është Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

#### Neni 4

#### Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t’u zbatuar nga çdo zyrtar pranë Autoritetit të Konkurrencës, sipas përcaktimit në pikën 1 gërma “b” të nenit 4 të kësaj rregulloreje, i cili ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit si dhe merr pjesë në vendimmarrje.

## Neni 5

### Vendimmarrja për një akt

Për qëllimet e kësaj rregulloreje:

- a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara sipas ligjit:

## Neni 6

### Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar i Autoritetit të Konkurrencës ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 5 të kësaj Rregullore përcakton përmbajtjen e vetë aktit.
2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt përfshihet në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:
  - a) roli zyrtar dhe/apo pozicioni urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi për përgatitjen e aktit;
  - b) zotërimin e informacionit, në lidhje me aktin, që lidhet kryesisht me të dhëna të ndjeshme për biznesin, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes penale, informacione për politikat ekonomike vendore dhe administrimin financiar;
  - c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, do të përbëjë çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga Autoriteti Përgjegjës i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe nga eprorët e një zyrtari në këtë Institucion.
4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari, pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, për nxjerrjen e aktit konkret është detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1, të nenit 7 të Ligjit, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji.
5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pikës 2 të Ligjit
6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt interesi të zyrtarit, vepron sipas nenit 37 të Ligjit.

## Neni 7

### Interesat privatë

1. Interesat konkrete që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave, si dhe masa e kufizimit të tyre janë konkretisht:
  - a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
  - b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
  - c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
  - ç) negociime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negociime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;
  - d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;
  - dh) **marrëdhënie:**
    - i) familjare apo të bashkëjetesës;
    - ii) të komunitetit;
    - iii) etnike;
    - iv) fetare;
    - v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.
2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë rregullore, zbatohen së bashku me kufizimet e përcaktuara në nenin 23 të ligjit Nr. 9721, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.
3. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i një zyrtari, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit.



## **KREU II**

### **PROCESI I IDENTIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KONFLIKTIT TË INTERESIT**

#### **Neni 8**

##### **Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit**

1. Çdo zyrtar i Autoritetit të Konkurrencës, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetë-deklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga eprori ose institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi mund të kërkohet dhe të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetë-deklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt dhe i bashkëngjitet praktikës përkatëse të vendimmarrjes.

#### **Neni 9**

##### **Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë**

Ofrimi i informacionit për interesat private të zyrtarit është:

- a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijëni;
- b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijëni dhe që ka interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e Ligjit.

Burime të tjera informacioni për interesat private të një zyrtari, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të Ligjit

#### **Neni 10**

##### **Lëshimi i autorizimit nga zyrtari**

1. Autoriteti i Konkurrencës (autoriteti pergjegjes) vë në dispozicion të zyrtarëve të saj modelin e autorizimit, që këta duhet të lëshojnë brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.
2. Çdo zyrtar që merr pjesë në një grup pune është i detyruar të deklarojë nëse ka apo nuk ka konflikt interesi në këtë grup pune.
3. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të Autoritetit të Konkurrencës.

## Neni 11

### Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje në Autoritetin e Konkurrencës janë:
  - a) Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës dhe eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë;
  - b) Sekretari i përgjithshëm dhe eprorët e zyrtarëve, sipas hierarkisë brenda Sekretariatit
2. Autoriteti përgjegjës në Autoritetin e Konkurrencës, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në Ligj dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje është Drejtori i Drejtorisë së Sherbimeve të Brendshme (Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sherbimeve dhe Dokumentacionit).

## Neni 12

### Detyrat e Autoritetit Përgjegjës (Drejtori i Drejtorisë së Sherbimeve të Brendshme)

1. Autoriteti Përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të akteve të Autoritetit të Konkurrencës, të nxjerra në zbatim të kësaj rregulloreje, është i autorizuar që, në mënyrë aktive, në emër të Autoritetit të Konkurrencës:
  - a) të mbledhë nga burimet e ligjshme të informacionit të dhëna për interesat privatë të zyrtarëve në Autoritetin e Konkurrencës;
  - b) të pranojë informacionet e siguruar në mënyrë të ligjshme;
  - c) të verifikojë besueshmërinë e këtyre informacioneve;
  - ç) të vërë në dijeni zyrtarin për informacionet e siguruar për të dhe t'i japë mundësi zyrtarit të provojë të kundërtën, nëse ky i fundit e kërkon një gjë të tillë;
  - d) të bëjë regjistrimin e interesave privatë të zyrtarit, jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës në Autoritetin e Konkurrencës.
  - dh) të shpërndajë dhe mbledhë autorizimet e detyrueshme për t'u lëshuar nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës, sipas nenit 10 të Ligjit dhe nenit 12 të kësaj Rregulloreje.
  - e) të krijojë regjistrin përkatës dhe mbajë regjistrimet rast për rast të konfliktit të interesit;
  - f) bazuar në regjistrimin dhe vlerësimin e interesave private të zyrtarëve të Autoritetit të Konkurrencës, u sugjeron atyre dhe/ose eprorëve të tyre, çështjet dhe momentet kur zyrtarët, dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e:
    - i. konfliktit rast për rast të interesit (faktik, në dukje dhe të mundshëm);
    - ii. konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
  - ë) kryen me autorizim të Kryetarit të Komisionit të Konkurrencës, verifikim të interesave të deklaruara apo të padeklaruara të zyrtarëve dhe punonjësve

të këtij institucioni, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë që i jep ligji, dhe informon për këtë, sipas rastit Kryetarin e Komisionit të Konkurrencës;

- f) mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të Ligjit;
- g) përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimit të tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;
- gj) merr masa për të siguruar aksesin e informimit të publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit;
- h) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Integritet:
  - i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt të interesit, zyrtarëve përgjegjës, si dhe mbështesin Autoritetin e Konkurrencës në ndërmarrjen e hapave ligjore për dëmshpërblimin e palëve të treta të dëmtuara dhe kalimin e barrës së dëmshpërblimit të zyrtarëve përgjegjës;
  - ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me rregulloren dhe urdhrat e miratuara nga Komisioni i Konkurrencës;
  - iii. shtrojnë çështje dhe kërkojnë këshilla nga Kryetari i Komisionit të Konkurrencës, për zbatimin e Ligjit, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;
- i) mbështet ILDKP-në në kryerjen e deklaramit periodik të interesave nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës;
- j) njofton me shkrim ILDKP-në për rastet e largimit nga funksioni të zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklaramit të interesave private periodike në ILDKP;
- k) njofton me shkrim ILDKP-në për rastet e emërimit të zyrtarëve që mbartin detyrimin për deklaramit të interesave private periodike në ILDKP;
- l) bën me dije zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës për çdo këshillë apo udhëzim të ILDKP-së;
- ll) mbështet misionet monitoruese, vlerësuese apo të verifikimit dhe të hetimit administrativ të ILDKP-së për zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës
- m) i paraqet ILDKP-së çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të Ligjit, përfshirë rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklaramit periodik;
- n) ndjek e zbaton detyra të tjera që i ngarkohen sipas kësaj rregulloreje ose urdhrave të titullarit të institucionit në zbatim të Ligjit.

### **KREU III**

## **MËNYRAT E TRAJTIMIT DHE TË ZGJIDHJES SË KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

### **Neni 13**

#### **Mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave**

Për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti interesi, të çdo lloji qoftë ai:

1. Çdo zyrtar apo epror i zyrtarit, duke filluar nga ai më i afërt, në ushtrimin e funksioneve të tyre, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e parashikuara ne pikat 1 dhe 4 të nenit 37 të Ligjit.
2. Zyrtari njofton eprorin ose institucionin epror, sipas rastit, për zgjidhjen e sugjeruar ose të marrë dhe provon e dokumenton këtë zgjidhje.
3. Eprori njofton me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar zyrtarin në konflikt interesi, si dhe eprorin e vet për zgjidhjen e dhënë.
4. Pavarësisht pikave të mësipërme, zyrtarët përgjegjës, për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit, nuk çlirohet nga përgjegjësia e rënies në konflikt interesi, kur masat e marra nga vetë ai nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e tij.

Autoriteti Përgjegjës, në trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave, mban parasysh edhe ligjet specifike në fushën e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit, sipas këtij neni, duhet të bëhen bazuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet zyrtarit dhe eprorit, duke synuar së bashku përdorimin e mënyrës më të mirë për parandalimin dhe zgjidhjen e gjendjes me konflikt interesi.

### **Neni 14**

#### **Zgjidhja e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave**

Kur trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të vazhdueshëm të interesit nuk mund të arrihet nëpërmjet mënyrave të dhëna në nenin 37 të ligjit, që zyrtari të vazhdojë të qëndrojë në të njëjtin funksion, duhet detyrimisht të zgjidhë çështjen e konfliktit të interesit me një nga mënyrat e parashikuara në nenin 38 të tij.

### **Neni 15**

#### **Sanksionet**

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, kur nuk përbën veprë penale, përbën Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore nga zyrtarët

përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative. Masat disiplinore zbatohen në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve.

2. Konkurrencës, i propozon kryetarit të AK-së largimin nga funksioni të këtij anëtari.
3. Mosdhënia e autorizimit, sipas pikës 1, të nenit 13 të kësaj rregulloreje sjell ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.

### **Neni 16**

Për çështjet të cilat nuk mund të zgjidhen në këtë rregullore, aplikohet Ligji në mënyrë të drejtpërdrejtë.

### **Neni 17**

#### **Ndryshime në Rregullore**

Ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Autoritetit Përgjegjës në përputhje me Ligjin dhe udhëzimet e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 84 Datë 14.07.2008**

**Mbi**

**Autorizimin e përqendrimit të përfutimit të plotë të kontrollit në shoqërinë  
EUROMAX Shpk nga shoqëria DELTA MAXI d.o.o dhe shoqëria  
Weakstead Real Estate B.V**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.07.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë, të kapitalit të shoqërisë EuroMax shpk nga shoqëria Delta Maxi d.o.o. dhe shoqëria Weakstead Real Estate B.V, realizuar në datë 19 Maj 2008.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit, në lidhje me përfutimin e plotë të kontrollit në shoqërinë EUROMAX Shpk nga shoqëria DELTA MAXI d.o.o dhe shoqëria Weakstead Real Estate B.V,

## V Ë R E N S E:

### I. Palët e përfshira

1. **Euromax SHPK**, në cilësinë e shitësit, është themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Tiranë, Shqipëri. Objekti i veprimtarisë së tij është tregëtimi me pakicë i produkteve të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore të realizuar nëpërmjet një rrjeti prej 12 supermarketesh të shtrira brenda territorit të Shqipërisë së mesme, konkretisht në Tiranë (8), Durrës (2), Elbasan (1), Fier (1).  
Në vitin e fundit financiar (2007) xhiro totale e realizuar në tregun e brendshëm nga shoqëria Euro Max shpk është 2 miliard e 436 milion lekë.
2. **Delta Maxi d.o.o.**, në cilësinë e blerësit, përfton kontrollin e 95% të kapitalit të shitësit. Delta Maxi d.o.o është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit serb, me seli në Beograd, Serbi. Veprimtaria e saj është tregëtia më pakicë për produkte të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore, nëpërmjet rrjetit të supermaketeve të shtrira në Serbi, Bosnje, Mal të zi dhe Bullgari.
3. **Weakstead Real Estate B.V**, në cilësinë e blerësit, përfton 5% të kapitalit të shitësit. Weakstead Real Estate B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në mars 2008 sipas legjislacionit hollandez, me seli në Amsterdam, Hollandë, me objekt ushtrimi i veprimtarisë në fushën e pasurive të palujtshme.  
Xhiro totale për vitin 2007, e realizuar në tregun ndërkombëtar nga blerësit është 70 miliard e 67 milion lekë.

### II. Transaksioni

4. Marrëveshja e shitblerjes së kuotave është nënshkruar më datë 19 maj 2008. Ky transaksion konsiston në përfitim 100% të kapitalit dhe të së drejtës së votës së shoqërisë të Euromax shpk, nga shoqëritë Delta Maxi Ltd. dhe Weakstead Real Estate B.V., respektivisht pjesët 95% dhe të 5% të kapitalit.

### TREGU I PRODUKTIT:

5. Tregtimi me pakicë i produkteve ushqimore dhe jo ushqimore

### TREGU GJEGRAFIK:

6. Tregu Republikës së Shqipërisë.

### III. Analiza e Konkurrencës

7. Palët pjesëmarrëse ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel të tregut të produktit: tregtimi me pakicë i produkteve të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore, nëpërmjet rrjetit të supermaketeve/ dyqane jo të specializuara. Veprimtaria e tyre nuk ka mbivendosje /tregje të prekura, mbasi palët veprojnë në tregje të ndryshme gjeografike dhe nuk kanë klientë të përbashkët.
8. Produktet e ofruara nga palët pjesëmarrëse në përqendrim janë përgjithësisht homogjene.

**IV. Tendenca e tregut**

9. Tregu i shitjeve me pakicë në forma të organizuara (hipermarket dhe supermaket) është një formë e re atraktive e biznesit në Evropën Juglindore. Në Shqipëri, veprimtaria e tregtimit me pakicë (retail) ka filluar të zhvillohet gjatë viteve të fundit.
10. Tregu karakterizohet nga një zhvillim dinamik përsa i takon shtrirjes gjeografike, shtimit të hipermarketeve dhe supermarketeve si në Tiranë edhe në rrethe të tjera të vendit, si dhe rritjes së cilësisë së shërbimit në to.

**V. Si konkluzion:**

11. Përftimi i plotë i kontrollit nga shoqëritë Delta Maxi d.o.o dhe Weakstead Real Estate B.V mbi veprimtarinë tregtare (rrjetin e supermarketeve) të Euromax shpk nuk krijon ose forcon një pozitë dominuese në tregun përkatës.

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

**VENDOSI:**

Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të plotë të kontrollit në shoqërinë Euromax Shpk nga shoqëritë Delta Maxi d.o.o dhe Weakstead Real Estate B.V.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(\_\_\_\_\_)  
Zv/Kryetar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**


---

**K R Y E T A R E**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 85 Datë 29.07.2008**

**Mbi**

**Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë  
Wrigley Jr. Company dhe shoqërisë Mars Incorporated**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit, të shoqërisë Mars Incorporated dhe shoqëria Wrigley Jr. Company.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, Kreu IV “Procedurat për kontrollin e përqendrimeve” nenet 53-56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit, në lidhje me bashkimin e shoqërisë Wrigley company dhe shoqërisë Mars Incorporated,

**V Ë R E N S E:**

Njoftimi i përqendrimit me objekt bashkimin e shoqërisë Wrigley Jr. Company dhe shoqërisë Mars Incorporated, në emër të Mars Incorporated është depozituar në Autoritetin

e Konkurrencës në datën në datë 05 Maj 2008.

Mars Incorporated, në përputhje me nenin 4, pika 1 e Rregullores Nr. 139/2004, për transaksionin e kryer ka njoftuar Komisionin Europian në datën 20 Qershor 2008, si dhe Autoritetet e Konkurrencës të shteteve jo anëtare (Shqipëri, Bosnie-Hercegovinë, Kroaci, Mal i Zi, Serbi, Maqedoni), ku palët pjesëmarrëse në përqendrim janë prezente drejtëpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë në tregun e produktit.

Komisioni Europian, në bazë të nenit 4, paragrafëve 2, 3 dhe 4 të Rregullores së Komisionit Nr. 802/2004, ka pranuar marrjen e njoftimit dhe rregjistrimin e tij në rregjistrin e njoftimeve me Nr COMP/M. 5188- Mars/Wrigley.

Përqendrimi i propozuar është njoftuar për marrje autorizimi edhe pranë Federal Trade Commission (USA), si dhe Competition Bureau Canada, Brazil, Jordani, Australi, Meksikë, Kinë etj.,

Duke qënë se palët në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë prezent në tregun e produktit nëpërmjet distributorit, shoqërisë Interbrand<sup>1</sup>, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 2 të ligjit dhe zbatim të neneve 10 dhe 12, pika 1 të Ligjit, e konsideroi këtë transaksion si objekt të shqyrtimit nga ana e tij.

## I. Palët e përfshira

1. **WM WRIGLEY JR. COMPANY**, në cilësinë e shitësit, është themeluar në Tetor 1927 dhe funksionon sipas legjislacionit amerikan të shtetit Delaware, me seli në Wrigley Building 410 North Michigan Avenue, Chicago, Illinois 60611, SHBA.

Wrigley është një shoqëri e njohur ndërkombëtare për prodhimin dhe shitjen e çamçakizave (me markat më të njohura Orbit, Extra, Doublemint, etj) dhe konfeksioneve të sheqerit.

Shoqëria Wm. Wrigley Jr. Company operon me anë të filialeve të saj në më shumë se 180 vende dhe tre nga markat e saj më të njohura, Wrigley Spearmint, Juicy Fruit dhe Altoids kanë një historik ekzistence në treg gati një shekullor.

Xhiro totale realizuar nga Wrigley për vitin 2007 është:

- në tregun ndërkombëtar: 3.9 miliard Euro<sup>2</sup> = **47 miliard Lekë**; dhe
- në tregun e brendshëm: 4.9 milion Euro = **602 milion Lekë**

2. **MARS INCORPORATED**, në cilësinë e blerësit është një shoqëri me pronësi familjare, e themeluar në vitin 1911 sipas legjislacionit amerikan, me seli në Virginia, në adresë 6885 Elm Street, Mc Lean, Virginia 22101-3883, SHBA.

**Mars Incorporated** operon me anë të filialeve të saj në me shumë së 66 vende, në prodhimin dhe tregtimin e:

- produkteve ushqimore (si p.sh salcat, orizi),
- ushqim për kafshët shtëpiake (të markave Whiskas, Pedigree)
- çokollata, akullore, ( të markave Snickers, Dove, Mars, Bounty)

<sup>1</sup> Interbrand sha, me adresë, Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, distributori lokal tregton produktet e të dy ndërmarrjeve pjesëmarrëse në transaksionin e bashkimit

<sup>2</sup> Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007, 1 euro=123.6 lek. Burimi:Raporti Statistikor

- prodhime sheqeri (Skittels, Starbuck etj) dhe
- produkte në rritje në fushën e pijeve.

Xhiro totale realizuar nga Mars Incorporated, për vitin 2007, është:

- në tregun ndërkombëtar: **15.5 miliard Euro = 1906 miliard lekë<sup>3</sup>**; dhe
- në tregun e brendshëm: 875 000 Euro = **107 milion lekë**.

## II. Transaksioni

3. Marrëveshja dhe plani i bashkimit është nënshkruar më datë 28 prill 2008.

Ky transaksion do të financohet nëpërmjet kombinimit të rezervave nga burimeve e veta financiare të Shoqërisë Mars Incorporated dhe huasë së dhënë nga kompanitë: Berkshire Hathaway, Goldman Sachs dhe JP Morgan, të cilët në përfundim të transaksionit do të shlyhen nga kompania Wrigley. Ndërsa, financuesi më i madh, kompania Berkshire Hathaway do të blejë aksione në Wrigley në masën 19.3%, duke u bërë kështu edhe aksioner në minorancë në kompaninë e re (Mars-Wrigley)<sup>4</sup>, që pas bashkimit, do të ketë këtë strukturë:

- Mars Incorporated, zotëruesi i pjesës prej 80.7% të kapitalit; dhe
- Berkshire Hathaway, zotëruesi i pjesës prej 19.3% të kapitali.

Vlera e transaksionit të bashkimit është 23 miliard dollarë dhe vlera e çdo aksioni<sup>5</sup>, që do tu paguhet me para në dorë aksionerëve të Wrigley, është 80 \$.

Në përfundim të transaksionit, Mars do të transferojë veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të konfeksioneve të sheqerit tek Wrigley, e cila do të vazhdojë të qëndrojë si entitet i pavarur, filial brenda shoqërisë së re Mars-Wrigley, duke ruajtur emrin e vet.

### TREGU I PRODUKTIT:

4. Si treg i produktit do të konsiderohet produktet e tregtueshme në tregun e brendshëm për:
1. Embëlsirat (A. çokollata dhe B. jo çokollata) dhe
  2. Ushqim për kafshë shtëpiake, sipas nënndarjeve përkatëse të mëposhtme;
    - A. Në produktet e çokollatës tregtohen markat: Snickers, Mars, Twix, Bounty, Milky Way dhe M&M's.
    - B. Në produktet e jo-çokollatës përfshihen:
      - Çamçakizat e markave: Spearmint, Juicy Fruit, Doublemint, Big Red, Winterfresh, Extra, Freedent, Orbit, Hubba Bubba, Airwaves, Cool Air, Eclipse, etj, dhe;
      - Konfeksionet e sheqerit<sup>6</sup> të markave: Altoids, Orbit, Solano, Sugus, Winterfresh etj

<sup>3</sup> Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2007, 1 euro=123.6 lek. Burimi:Raporti Statistikor

<sup>4</sup> Berkshire Hathaway nuk do të ketë të drejta të cilat mund t'i japin kontroll të përbashkët mbi Wrigley

<sup>5</sup> Të klasës së aksioneve të zakonshme dhe aksioneve të zakonshme të klasës B

<sup>6</sup> Ku bëjnë pjesë karamelit e buta dhe të forta, që prodhohen nga të dy shoqëritë, por sipas markave të veçanta)

Çokollata, çamçakizi dhe konfeksionet e sheqerit nuk janë produkte të zëvendësueshme dhe as plotësuese të njëra tjetrës.

Produktet, të cilat prodhohen nga të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në përqendrim dhe që kanë karakteristika të përbashkëta dhe qëllim të njëjtë përdorimi, të cilat konsiderohen si produkte të zëvendësueshme ose të shkëmbyeshme, janë vetëm konfeksionet e sheqerit, që prodhohen dhe tregtohen nga të dy kompanitë, por sipas markave të ndryshme.

#### TREGU GJEOGRAFIK: Territorri i Shqipërisë

5. Në Shqipëri, Mars dhe Wrigley janë aktive në tregun e produktit, nëpërmjet të njëjtit distributor, shoqërisë Interbrands Sha., me qendër në Tiranë dhe me degë rajonale (pika shumice), në 12 qytete si Korçë, Fier, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë, Elbasan, Pogradec, Lushnje, Berat, Laç, Kavajë.

### III. Analiza e Konkurrencës

6. Bashkimi ndërmjet shoqërive Mars Incorporated dhe Wrigley do të zgjerojë tregun gjeografik, duke tregtuar gamën e produkteve të Mars në tregje të zotëruara më parë vetëm nga Wrigley, si dhe duke nxitur dhe zhvilluar inovacionet, bashkimin e logjistikës në shpërndarjen e produkteve rritet kështu konkurrueshmëria dhe për rrjedhim rritet eficiencia e tregut.
7. Mars dhe Wrigley në Europë operojnë me anë të filialeve të tyre në: Austri, Poloni, Hollandë, Gjermani dhe Francë, Mbretërinë e Bashkuar (UK). Distributori kryesor për produktet e shoqërisë Mars për Europën është në Hollandë, nga ku produktet e prodhuara importohen për në tregun shqiptar, nga shoqëria Interbrand ShA, i cili është edhe shpërndarës jo ekskluziv në tregun e brendshëm.
8. Palët pjesëmarrëse janë prezente në tregun e brendshëm, nëpërmjet tregtimit të markave të produkteve të tyre. Shoqëria Mars Incorporated nuk është e pranishme në tregun e brendshëm për konfeksionet e sheqerit<sup>7</sup> kështu që nuk ka mbivendosje për produktet që janë të zëvendësueshme.
9. Realizimi i përqendrimit, nuk sjell ndryshime në treg pasi distributor i produkteve të të dy shoqërive mbetet shoqëria Interbrands sha, që e kryente këtë veprimtari edhe para këtij transaksioni. Pjesa e tregut që zënë produktet e çokollatës është 10%, ndërsa produktet e çamçakizit dhe konfeksioneve të sheqerit është 75%.
10. Konkurrentet më të mëdhenj të Mars-it dhe Wrigley në Shqipëri janë:

Për çokollatat, shoqëritë:

- Kraft (markat kryesore Milka, Toblerone, që zënë 40% të tregut),
- Nestlé (markat kryesore Kitkat, Lion- 26% të tregut);
- Ferrero (markat kryesore Kinder, Duplo dhe Kinder Buenno me pjesë tregu 5%);
- Ulker (markat kryesore Luna, Twingo dhe Metro me pjesë tregu 7%);

<sup>7</sup> Në bazë të përkufizimit të tregjeve të prekura sipas seksionit 6(III) të “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, nuk ka tregje të prekura nga përqendrimi i njoftuar.

Për çamçakizat shoqëritë:

- shoqëria Cadbury me markat Stimorol, Trident me pjesë tregu 7%
- Shoqëria Perfetti me markat Happydent, Vivident, Big Babol me pjesë tregu 15%.
- Shoqëria Intergum me markat Taxi dhe Kola

Për konfeksionet e sheqerit shoqëritë:

- Perfetti me markat Mentos, Golia dhe Alpen Liebe,
- Ferrero me market Tic Tac,
- Cadbury me marken Halls.

#### V. Si konkluzion:

11. Transaksioni i njoftuar që konsiston në bashkimin ndërmjet shoqërive Mars Incorporated dhe Wrigley dhe transferimin e veprimtarisë të prodhimit dhe tregtimit të konfeksioneve të sheqerit nga Mars tek Wrigley, nuk krijon ose forcon pozitën dominuese të produkteve të Mars Incorporated dhe Wrigley në nivelin e shpërndarjes në tregun e brendshëm. Për pasojë nuk kemi kufizim të konkurrencës në këtë nivel tregu.

### PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

#### VENDOSI:

Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të shoqërisë Wrigley Jr. Company, me qendër në shtetin Delaware, SHBA dhe shoqërisë Mars Incorporated, me qendër në Virginia, SHBA, mbasi pasojat e tij nuk ndikojnë në konkurrencën e tregut të produkteve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

(\_\_\_\_\_)

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**KRYETARE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr. 86 Datë 29.07.2008**

**Për mos klasifikimin si përqendrim të bashkimit me përthithje të shoqërive  
CT Telekom dhe Albtelekom Sh.a**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2008, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje ndërmjet shoqërive CT Telekom dhe Albtelekom”.

**Baza ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” neni 25. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit, në lidhje me përfundimin e plotë të kontrollit në shoqërinë EUROMAX Shpk nga shoqëria DELTA MAXI d.o.o dhe shoqëria Weakstead Real Estate B.V,

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë CT Telekom nga Albtelekom,

**V Ë R E N S E:**

**Palët pjesëmarrëse** të përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në transaksion:

1. Albtelekom SHA, shoqëria përthithëse është rregjistruar në regjistrin tregtar me Vendimin Nr 20820, datë 16 shkurt 1999 dhe përbëhet nga dy aksionerë:

- a) CT Telekom sha- 76% të kapitalit; dhe
  - b) Shteti Shqiptar, përfaqësuar nga METE- 24% të kapitalit.
2. **Shoqëria CT Telekom ShA**, shoqëria e përthithur, e krijuar dhe që vepron në përputhje me Ligjin nr 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, rregjistruar në Qendrën Kombëtare të rregjistrimit në Tiranë, Shqipëri me çertifikatën SN-000506-09-07, datë 21.09.2007.

Aksioneri i vetëm 100% i shoqërisë CT Telekom sh a (shoqëri bijë), është shoqëria Çetel Telekom (shoqëria mëmë).

Shoqëria CT Telekom ShA, shoqëria e përthithur, zotërohet 100% nga shoqëria Cetel Telekom.

#### **Palët e përfshira në mënyrë të tërthortë në transaksion dhe lidhjet ndërmjet tyre:**

3. **Cetel Telekom**, shoqëri anonime e themeluar dhe e krijuar më 18 qershor 2007 sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, me kapital të përbërë 20% nga Turk Telekom dhe 80% Cetel Calik Energji. Cetel Telekom zotëron në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet bijës së saj, 76% të kapitalit dhe të së drejtës së votës në shoqërinë Albtelekom.

Shoqëria CETEL Telekom ka blerë 76% të aksioneve në shoqërinë Albtelekom, duke përfutur paketën mazhoritare të kontrollit në të. Transaksioni është autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr 54, datë 4.09.2007.

Përrealizimin e këtij transaksioni, shoqëria Çetel Telekom, themeloi shoqërinë CT Telekom, të zotëruar direkt nga Cetel Telekom<sup>1</sup>. Qëllimi i krijimit dhe objekti i veprimtarisë së CT Telekom ishte realizimi i përfutimit të kontrollit për pjesën 76% të kapitalit në shoqërinë Albtelekom sha.

#### **Përshkrimi i transaksionit**

Aksionerët e Albtekomit, me datën 17 korrik 2008 kanë nënshkruar marrëveshjen e bashkimit me përthithje, ku Albtelekom është shoqëria përthithëse dhe CT Telekom shoqëria e përthithur, i parashikuar edhe në kontratën e shitblerjes së aksioneve të permendur më lart. Pas realizimit të bashkimit me përthithje CT Telekom, i cili deri tani ka zotëruar 76% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në shoqërinë Albtelekom sha do të pushojë së ekzistuari dhe Cetel Telekom, shoqëria mëmë, do të marri në zotërim 76% të aksioneve të Albtekomit, ndërsa shteti shqiptar, i përfaqësuar nga METE do të mbajë 24% të aksioneve të shoqërisë Albtelekom ShA.

Transaksioni i realizimit të bashkimit me përthithje ndërmjet shoqërive Albtelekom Sha dhe CT Telekom sha nuk ndryshon formën ligjore të njësisë që rezulton pas përqendrimit, duke mos sjellë asnjë ndryshim në kapitalin aksionar dhe të së drejtës së votës brenda shoqërisë Albtelekom SHA., që do të thotë pa shkaktuar ndryshime në cilësinë e kontrollit.

<sup>1</sup> Kontrata për blerjen e aksioneve (KBA), Neni 8, paragraf 8.3 dhe 8.4- Titulli i pronësisë mbi aksionet.

**PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 25 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,

**VENDOSI:**

1. Të mos klasifikojë njoftimin për “Bashkimin me përthithje të shoqërisë CT Telekom nga Altelekom Sh.a”, si përqendrim në zbatim të neneve 10 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

( )  
Zv/Kryetar

( )  
Anëtar

( )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**